



STUDIM MBI SHËRBESAT E
KISHAVE UNGJILLORE
ME FËMIJËT DHE
FAMILJET E CENUESHME

SHËRPIERJA





TABELA E PËRMBAJTJES

3	<u>Hyrje</u>
4	<u>Përkufizime</u>
6	<u>Gjetjet kryesore</u>
9	<u>Rreth studimit</u>
14	<u>Shërbesa me fëmijët dhe familjet e cenueshme</u>
31	<u>Shërbesa me fëmijët pa kujdes prindëror</u>
35	<u>Integrimi i Ungjillit</u>
37	<u>Burime dhe partneritete</u>
40	<u>Nevojat e kishave</u>
42	<u>Pyetje për reflektim dhe diskutim</u>





HYRJE

Komunitete të ndryshme në mbarë botën kanë sfidat dhe vështirësitë e tyre të veçanta. Studimi na ndihmon që të kuptojmë se si qëndrojnë punët, në kohë dhe vende të ndryshme. **KY STUDIM HEDH VËSHTRIMIN NË SITUATËN E KISHAVE UNGJILLORE NË SHQIPËRI, VEÇANËRISHT SE SI KISHAT PO U SHËRBEJNË FËMIJËVE DHE FAMILJEVE TË CENUESHME.**


Edhe pse Shqipëria është shfaqur si një nga vendet drejtuese në gjeopolitikën e Ballkanit, jo shumë kohë më parë ishte një nga vendet më të varfra në Evropë. Që nga rënia e regjimit komunist në vitin 1991, vendi ka përjetuar ndryshime të mëdha politike dhe ekonomike, të cilat kanë ndikuar thellësisht në shoqërinë shqiptare, veçanërisht në strukturat familjare dhe sistemet e mirëqenies së fëmijëve.

Shumë familje vazhdojnë të përballen me vështirësi ekonomike. Grupet e cenushme, si fëmijët pa kujdes prindëror, komunitetet rome dhe egjiptiane dhe viktimat e dhunës në familje, shpesh nuk marrin mbështetje të mjaftueshme sociale. Në përgjigje ndaj këtyre sfidave, kisha ungjillore, një nga pesë besimet e njohura zyrtarisht në Shqipëri, po merr një rol gjithnjë e më të rëndësishëm duke ofruar ndihmë praktike dhe kujdes shpirtëror për fëmijët dhe familjet e cenushme.

Të kuptuarit e kontekstit të veçantë kulturor, shoqëror dhe fetar të Shqipërisë është thelbësor për zhvillimin e qasjeve efektive dhe të qëndrueshme në shërbesë. Kisha ka potencialin të jetë një faktor transformues në mbështetjen e fëmijëve dhe forcimin e familjeve në mbarë vendin.

Ruth Vergnon punon me fëmijë të cenushtëm nëpërmjet Alo ! Mik, një organizatë në Shqipëri që mbështet fëmijët me trauma komplekse ose që kanë humbur një kujdestar (<https://alomik.org/>). Në vitin 2023, ajo iu drejtua OneHope me dëshirën për të hulumtuar në mënyrë sistematike se si kishat në Shqipëri po mbështesin familjet e cenushme. Si përgjigje, ne intervistuam 90 udhëheqës kishash ungjillore rreth përpjekjeve të kishave të tyre për të ndihmuar familjet dhe fëmijët e cenushtëm. Ky raport, i krijuar nga Alo ! Mik, World Without Orphans dhe OneHope, analizon këto përgjigje, duke theksuar aktivitetet aktuale të shërbesave dhe fushat ku nevoja për zhvillim është më e madhe.

Ndërsa shqyrtoni gjetjet, ju lutemi të mbani parasysh se këto rezultate janë nxjerrë nga intervistat me udhëheqësit e kishave. Vlerësimet e dhëna, si numri i fëmijëve të shërbyer apo shërbesat e zhvilluara, pasqyrojnë këndvështrimin e një udhëheqësi dhe jo një vlerësim të thelluar të shërbesave. Qëllimi ynë kryesor është të evidentojmë sfidat më të mëdha me të cilat përballen familjet e cenushme, më tepër sesa të japim të dhëna përfundimtare mbi numrin e tyre apo përmasat e shërbesave që ofrojnë kishat. Shifrat e paraqitura këtu janë vetëm një pjesë e një hulumtimi më të gjerë mbi nevojat dhe mundësitë brenda komuniteteve të cenushme në Shqipëri.





Të dhënat janë mbledhur midis muajve nëntor 2023 dhe korrik 2024. Ju lutemi që të keni parasysh se disa totale në këtë raport mund të mos arrijnë gjithmonë 100% për shkak të rumbullakosjes së numrave dhjetorë. Për disa pyetje të tipit “zgjidhni gjithçka që vlen”, shumat totale mund edhe të tejkalojnë 100%.

Shpresojmë që ky raport të nxisë diskutime të hapura për sfidat dhe mundësitë në mbështetje të fëmijëve dhe të rinjve të cenueshëm.




PYETJET KRYESORE TË KËTIJ STUDIMI

- Si po kujdesen kishat në Shqipëri për fëmijët dhe familjet e cenueshme?
- Si po i dishepullizojnë kishat në Shqipëri fëmijët dhe të rinjtë e cenueshëm?
- Si mund t'i pajisim më mirë kishat për të përmbushur nevojat e fëmijëve, të të rinjve dhe familjeve të cenueshme?

PËRKUFIZIME

Ky raport përqendrohet në **MËNYRËN SE SI KISHAT NË SHQIPËRI MBËSHTESIN FËMIJËT QË VIJNË NGA FAMILJE TË CENUESHME**. Ka shumë faktorë që mund ta bëjnë një familje të cenueshme. Në temat specifike për të cilat kemi pyetur në këtë studim, përfshihen:

- Vështirësia ekonomike (varfëria dhe/ose papunësia)
- Përjetimi i dhunës, abuzimi, ose neglizhenca
- Dëshmimi i dhunës në shtëpi ose komunitet
- Probleme të shëndetit mendor (tek prindërit)
- Abuzimi me substancat (tek prindërit)
- Anëtar të familjes në burg
- Paqëndrueshmëria si pasojë e ndarjes/divorcit të prindërve
- Përjetimi i tentimit për vetëvrasje ose vdekje nga vetëvrasja të një anëtari të familjes
- Vdekje në familje
- Fëmijë/të rinj me nevoja të veçanta (si paaftësi zhvillimore ose sëmundje fizike kronike)
- Prindër ose kujdestarë me njohuri të kufizuara rreth nevojave ose zhvillimit të fëmijëve
- Braktisje (përfshirë punën jashtë vendit)





Përveç këtyre sfidave, fëmijët që janë privuar nga kujdesi prindëror ose janë ndarë nga kujdestarët e tyre kryesorë, shpesh përballen me vështirësi shtesë dhe kanë nevojë për lloje të ndryshme mbështetjeje.

Ndërsa shumë njerëz mendojnë fillimisht për **JETIMËT** si fëmijë ku prindërit e të cilëve kanë ndërruar jetë, ka shumë rrethana të ndryshme që mund të çojnë në privimin e një fëmije ose të një të riu/reje nga kujdesi prindëror:

- **Jetim biologjik:** Ka humbur njërin ose të dy prindërit.
- **Jetim social:** E kanë larguar nga shtëpia dhe e kanë vendosur në vende të tjera për shkak të rrethanave familjare.
- **Jetim në shpirt:** I ka kujdestarët fizikisht por për shkak të neglizhencës, abuzimit ose shfrytëzimit, nuk ndihet i sigurt emocionalisht për të kërkuar ndihmë nga të rriturit e tjerë përreth.



“Duke mos njohur nevojat dhe fazat e zhvillimit të fëmijëve, prindërit lënë shumë boshllëqe në jetën e tyre. Fëmija ka mungesa emocionale dhe psikologjike dhe ndihet si jetim me prindër gjallë.”

- Pastor


GJETJET KRYESORE

STATISTIKA TË VEÇANTA


90
UDHËHEQËS
KISHASH TË
PYETUR

89% e udhëheqësve të kishave identifikojnë vështirësitë ekonomike si një çështje kritike që ndikon te fëmijët dhe të rinjtë e kishës së tyre.

61% E KISHAVE kanë një politikë specifike për mbrojtjen e fëmijëve të cënueshëm, por vetëm **13% (11 kisha)** e përdorin në mënyrë aktive këtë politikë.



4 në 10 thonë se më shumë se **40%** e fëmijëve dhe të rinjve në bashkësinë e tyre vijnë nga **familje të cënueshme**.

Llojet MË PAK të zakonshme të mbështetjes që ofron kisha janë:


Vakte
ushqimore:
21%

Programet pas-
shkollore: 27%




Mbështetje
psikologjike:
32%

61%
e udhëheqësve të kishave
thonë se shumica e
fëmijëve vijnë
në kishë pa
prindërit e
tyre.



PANORAMA E SHËRBESAVE

Shumica e kishave **raportojnë se kanë midis 11 dhe 50 fëmijë** të përfshirë në shërbesën e tyre. Pjesëmarrja e të rinjve është pak më e ulët mesatarisht, por përsëri shumica raportojnë midis 11 dhe 50 pjesëmarrës.

Kishat e vogla dhe në zonat rurale kanë më shumë gjasa që fëmijët dhe të rinjtë të vijnë pa prindër.

PROBLEMATIKAT MË TË ZAKONSHME



ME TË CILAT
PËRBALLEN
FËMIJËT DHE
TË RINJTË



Vështirësia ekonomike

89%

Dhuna ose neglizhenca

33%

Prindër/Kujdestarë me njohuri të kufizuara për nevojat e fëmijëve

29%

Sfida të lidhura me ndarjen e prindërve

25%

62 kisha thonë se po u shërbejnë aktualisht familjeve të cënueshme. Shumica ofrojnë mbështetje çdo muaj, një numër më i vogël shërbejnë çdo javë (11) ose sipas nevojës (23).

Mënyrat më të zakonshme me të cilat udhëheqësit e kishave mbështetin fëmijët, të rinjtë dhe familjet e cënueshme janë nëpërmjet shpërndarjes së ndihmave, vizitave në familje dhe mentorimit.

15% e kishave kanë një marrëveshje formale me autoritetet vendore për bashkëpunim në shërbesën e tyre.

GJËRA PËR T'U FESTUAR



ANGAZHIM I LARTË

Udhëheqësit e kishave raportojnë një nivel të lartë angazhimi nga fëmijët e cënueshëm që frekuentojnë shërbesat e tyre. Ata thonë se më shumë se gjysma e këtyre fëmijëve janë shumë të angazhuar ose të angazhuar në një nivel të lartë. Kjo thekson potencialin e fortë të kishave për të ofruar mbështetje për këta fëmijë dhe të rinj.

96% e kishave të intervistuar u shërbejnë familjeve të cënueshme nëpërmjet shpërndarjes së ndihmave.

HARMONIZIM I MIRË

Ofrimi i një kujdesi kuptimplotë për fëmijët dhe familjet e cënueshme është një përparësi për udhëheqësit e kishave. Të intervistuarit theksuan rëndësinë e integritit në komunitet. Gjithashtu, ata po punojnë për të plotësuar nevojat bazë dhe për të ofruar mbështetje emocionale përmes vizitave, lutjeve dhe dëgjimit të vëmendshëm.

Gjysma e udhëheqësve të kishave thanë se ka pjesëtarë të kishës së tyre të cilët mbështesin fëmijë pa kujdes prindëror.

80% e udhëheqësve të kishave thanë se autoritetet vendore janë në dijeni të punës që ata bëjnë me shërbesat që kanë.



GJËRA PËR TË SHQYRTUAR



PROBLEMATIKA NË SHTËPI

Kur mendojmë për çështjet kritike me të cilat përballen fëmijët dhe të rinjtë e cënueshëm, udhëheqësit e kishave theksojnë sfidat në shtëpi si **divorci, dhuna në familje**, dhe shumë çështje të tjera më pak të dukshme si **abuzimi dhe varësia**.

Çfarë roli mund ose duhet të luajë kisha në adresimin e mosfunksionimit të familjes, të cilin e përjetojnë anëtarët e saj?



TEMA TË VËSHTIRA

Dy tema shumë sfiduese në këtë raport janë mbizotërimi i **dhunës dhe varësisë në shumë komunitete**. Përjetimi i dhunës, abuzimit ose neglizhencës u zgjodh nga një e treta e udhëheqësve të kishave si një çështje kritike me të cilën përballen fëmijët e cënueshëm.

Këto nuk janë çështje të lehta për t'u trajtuar. Çfarë strategjish shpresëdhënëse ose të dobishme keni parë për t'ju qasur çështjeve sfiduese si dhuna në komunitetin tuaj?



PRINDËRIT KANË NEVOJË PËR NDIHMË

Udhëheqësit e kishave shpesh theksojnë mungesën e ndërgjegjësimit të prindërve për nevojat e fëmijëve të tyre. Megjithatë, **vetëm 46% e kishave ofrojnë një**

lloj mbështetjeje të dedikuar për prindërit. Kjo tregon një mundësi për t'i ndihmuar prindërit që të bëhen kujdestarë dhe model më i mirë për fëmijët e tyre.

Çfarë mbështetjeje, nëse ka, ofroni për prindërit që mund të jenë në vështirësi në kontekstin tuaj?




SFIDA TË NDRYSHME

Udhëheqësit e kishave theksojnë sfidat e ndryshme me të cilat përballen fëmijët, të rinjtë dhe familjet e cënueshme, duke theksuar **nevojën për një gamë mbështetjeje, nga ajo ekonomike e sociale deri te ajo psikologjike e shpirtërore**.

Me kaç shumë nevoja që paraqiten në të njëjtën kohë, cilat janë disa nga fushat më strategjike ose me ndikim të lartë, për ndërhyrje nga kishat dhe institucione të tjera që ofrojnë përkujdesje?

RRETH STUDIMIT

RRETH PJESËMARRËSVE



Titulli ose roli	%	Numër
Pastor	71%	64
Koordinator/punëtor shërbese	14%	13
Plak kishe	10%	9
Punëtor me fëmijët	9%	8
Punëtor me të rinjtë	6%	5
Tjetër	9%	8

Për shkak se pjesëmarrësit mund të zgjedhnin disa përgjigje, shuma totale kalon 100%.

RRETH KISHAVE

Vendzhvillimet e studimit:



Shqipëria është e ndarë në 12 qarqe (zona) dhe në këtë studim janë përfshirë kisha nga çdo qark. Në këtë raport ne u referohemi katër rajoneve kryesore në të cilët grupohen këto qarqe si më poshtë:

- **Qendër:** Tiranë, Elbasan & Durrës
- **Veri:** Shkodër, Lezhë, Dibër & Kukës
- **Jugperëndim:** Fier & Vlorë
- **Juglindje:** Korçë, Gjirokastrë & Berat

Në çdo intervistë, të dhënat i kemi mbledhur nga një udhëheqës i kishës. Disa kisha operojnë në disa vendndodhje. Më shumë se gjysma e këtyre degëve të bashkësive ndodhen në zona rurale. Në mënyrë të përgjithshme, studimi pasqyron të dhëna nga rreth **154 vendndodhje individuale të kishave**. Për më shumë detaje mbi degët e kishave, referojuni Shtojcës B.




TË DHËNAT E STUDIMIT TË GRUPUARA SIPAS RAJONEVE



Shpërndarja Rajonale

- Qendër - 47 kisha
- Juglindje - 14 kisha
- Veri - 14 kisha
- Jugperëndim - 15 kisha



Mostra përfaqëson **më shumë kisha nga qendrat urbane** sesa nga zonat rurale. Në lidhje me madhësinë e kishës, shumica **(84%) kanë më pak se 80 anëtarë**. Më shumë se gjysma janë të lidhura me Vëllazërinë Ungjillore të Shqipërisë (VUSH), por kishat më të vogla janë më pak të prirura të jenë anëtare.



Kishat sipas vendndodhjes

- Zona Urbane - 57 kisha
- Kryeqyteti - 25 kisha
- Zona rurale - 7 kisha

MADHËSIA E BASHKËSISË (PËR DEGËN/KISHËN KRYESORE)



A jeni pjesë e Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë (VUSH)?



Po




Jo

Kishat në kryeqytet janë më të prirura të jenë pjesë e VUSH-it (76%), ndërsa kishat e vogla ishin më pak (41%).

RRETH SHËRBESAVE ME FËMIJË DHE TË RINJ

Sa fëmijë dhe të rinj janë pjesë e shërbesave që keni me ta, përfshirë edhe degët tuaja?



FËMIJË (5-12 VJEÇ)

TË RINJ (13-19 VJEÇ)

Do të donim të dijmë se **sa fëmijë dhe të rinj vijnë në kishë me prindërit**. Udhëheqësit e kishave raportojnë përqindje të larta të fëmijëve dhe të rinjve që vijnë në kishë pa prindër. Ata, gjithashtu, raportojnë një rritje të lehtë gjatë vitit të kaluar të këtyre fëmijëve që vijnë pa prindër.


SA PËRQIND E FËMIJËVE TUAJ VIJNË PA PRINDËR?

Fëmijë (5-12)




0-50%

51-100%




Udhëheqësit e kishave në zonat urbane dhe rurale ishin më të prirur të raportonin se më shumë se gjysma e fëmijëve vijnë në kishë pa prindërit.



KISHAT ME MË PAK SE 80 ANËTARË, gjithashtu, ishin më të prirura të raportonin përqindje më të lartë të fëmijëve që vijnë në kishë pa prindër.

Anëtarësia e kishës:




SA PËRQIND E TË RINJVE VIJNË PA PRINDËR?

Të rinj (13-19)



0-50%

51-100%



Përqindja e të rinjve që shkonin në kishë pa prindër ishte e ngjashme me atë të fëmijëve.



Në vitin e fundit, numri i fëmijëve dhe/ose i të rinjve që vijnë ME prindërit:

ËSHTË ZVOGËLUAR
19%



KA MBETUR PAK A SHUMË NJËLLOJ 59%



ËSHTË RRITUR
22%

Në vitin e fundit, numri i fëmijëve dhe/ose i të rinjve që vijnë PA prindër:

ËSHTË ZVOGËLUAR
17%




KA MBETUR PAK A SHUMË NJËLLOJ 57%




ËSHTË RRITUR
25%

NË VITIN E FUNDIT, NUMRI I FËMIJËVE DHE/ OSE I TË RINJVE QË VIJNË PA PRINDËR



KISHAT NË ZONAT RURALE raportojnë se numri i fëmijëve dhe të rinjve që vijnë vetëm, ose është rritur ose ka mbetur njëlloj, nuk ka raportim për zvogëlim.




Kjo është një mostër e vogël e vetëm gjashtë kishave në zonat rurale dhe mund të mos përfaqësojë plotësisht të gjitha bashkësitë e kësaj zone.

SHËRBESA ME FËMIJËT DHE FAMILJET E CENUESHME

Në thelb të këtij studimi qëndron dëshira për t'iu përgjigjur më mirë nevojave të fëmijëve, të të rinjve dhe të familjeve të cenueshme. Për ta arritur këtë, fillimisht duhet të kuptojmë se cilat janë nevojat e tyre dhe çfarë po bëhet tashmë për t'i mbështetur ata. Vlerësimi i aktiviteteve aktuale të shërbesave ndihmon në identifikimin e fushave ku mund të vazhdojmë, të thellojmë ose të nisim përpjekje të reja.

Fillojmë duke shqyrtuar sfidat specifike me të cilat përballen familjet shqiptare. Ka shumë faktorë që mund ta bëjnë një familje të cenueshme. Në këtë pjesë, të intervistuarit hedhin dritë mbi çështjet kritike që prekin familjet e fëmijëve dhe të rinjve në kishën e tyre.

Sa përqind e fëmijëve dhe të rinjve tuaj do të thoshit se VIJNË NGA FAMILJE TË CENUESHME?



SHËNIM INKURAJUES: UDHËHEQËSIT E KISHAVE RAPORTOJNË SE MË SHUMË SE GJYSMA E FËMIJËVE NGA FAMILJET E CENUESHME KANË NJË PËRFSHIRJE TË LARTË OSE SHUMË TË LARTË NË SHËRBESAT E TYRE. KJO TREGON SE SA MIRË JANË TË POZICIONUARA KISHAT PËR TË OFRUAR MBËSHTETJE DHE SHËRIM PËR FËMIJËT DHE TË RINJTË E CENUESHËM.





SI ËSHTË SHPËRNDARJA ETNIKE e familjeve të cënueshme me të cilat kisha juaj është në kontakt?


Shumica Shqipëtar Egjiptian Romë

66%

19%


12%

Sipas familjeve që u shërbejnë, rajonet e jugperëndimit dhe të qendrës, së bashku me zonat rurale, raportojnë përqindje më të larta për familjet rome, ndërsa kishat në zonat urbane raportojnë për më shumë familje egjiptiane. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se shumë njerëz në Shqipëri e kanë të vështirë të dallojnë midis romëve dhe egjiptianëve, prandaj këto përshtypje mund të mos reflektojnë plotësisht realitetet demografike.



PROBLEMATIKAT E IDENTIFIKUARA NGA KISHAT

Duke u bazuar në elementët e kësaj liste, cilat do të thoshit se janë 3 çështjet më kritike që përjetojnë fëmijët/të rinjtë e kishës suaj?



Për shkak se pjesëmarrësit mund të zgjedhnin disa përgjigje, shuma totale e kalon 100%.



PËRSE IDENTIFIKONI KËTO TË TRIA SI MË TË RËNDËSISHMET?

Shumë të intervistuar zgjedhën tri çështjet më kritike në bazë të eksperiencave në punën me fëmijët në komunitetin e tyre. Disa ofruan arsye të veçanta për zgjedhjet e tyre, të cilat janë organizuar në tema kryesore më poshtë. Çdo temë shoqërohet me thënie të drejtpërdrejta nga udhëheqësit e kishës, duke ofruar më shumë informacion mbi nevojat më urgjente të komunitetit të tyre.

TEMATIKA TË PËRBASHKËTA



VËSHTIRËSIA EKONOMIKE shpesh është identifikuar si shkak themelor që intensifikon sfida të tjera për familjet e cenushme. Udhëheqësit e kishave theksojnë se shumë nga çështjet që hasin familjet dhe fëmijët burojnë nga vështirësitë financiare.

"Vështirësia ekonomike sjell efekte anësore. Prindërit ikin jashtë vendit për punë, por braktisin fëmijët e tyre."

"Varfëria krijon një botëkuptim të ngushtë—ka sjellë divorce dhe ndarë familje. Kur burri nuk punon, lindin probleme të tjera."



Të intervistuarit shpesh theksuan **MUNGESËN E ARSIMIMIT DHE TË NDËRGJEGJËSIMIT** tek prindërit,

veçanërisht në lidhje me mbështetjen emocionale dhe psikologjike që u nevojitet fëmijëve. Ata theksojnë

rëndësinë e përmirësimit të aftësive prindërore për të përmbushur më mirë këto nevoja.

"Duke mos njohur nevojat dhe fazat e zhvillimit të fëmijëve, prindërit lënë shumë boshllëqe në jetën e tyre. Fëmija ka mungesa emocionale dhe psikologjike dhe ndihet si jetim me prindër gjallë."

"Kemi hasur prindër që ndihen të kënaqur duke siguruar vetëm nevojat bazë të jetës për fëmijën dhe nuk kërkojnë më shumë se kaq."



SITUATAT E VËSHTIRA FAMILJARE ishin një temë e përsëritur. Disa

nga të intervistuarit përmendën mungesën e prindërve për shkak të emigracionit—një problematikë prej shumë kohësh në Shqipëri—ndërsa të tjerë theksuan divorcin—



një trend i ri që po ndikon në paqëndrueshmërinë familjare. Në përgjithësi, ekziston ndjesia se shumë fëmijë po rriten me **vetëm një prind ose në kushte të vështira familjare**.

“Është e zakonshme që babai të shkojë jashtë Shqipërisë për të punuar, ndërsa nëna e ka shumë të vështirë të rrisë fëmijët.”

“Divorci i prindërve sjell pasiguri, frikë, ankth dhe traumë te fëmijët—si edhe vështirësi financiare. Kemi raste të fëmijëve, ku babai është në burg, dhe kjo ndikon në jetën e familjes, duke shkaktuar një zinxhir pasojash.”




DHUNA u përshkrua si një problem i përhapur kulturor, që vazhdon ciklet e **traumës dhe të abuzimit**. Përhapja e saj mund ta bëjë të duket normale dhe madje e domosdoshme në sytë e të rinjve.

“Ne jemi një shoqëri e dhunshme dhe kjo ndikon në rritjen e fëmijëve, duke rritur bullizmin dhe agresivitetin.

Ata e shohin dhunën si një mjet për të arritur atë që duan ose për të zgjidhur një problem. Dhuna bëhet pjesë integrale e jetës së tyre.”

“Ndoshta 70% deri 80% e popullsisë përjetojnë dhunë dhe vështirësi ekonomike. Jetojmë në një shoqëri ku dhuna është shumë e lartë.”



Përgjigjet e tjera vunë në dukje çështje më pak të dukshme, duke përfshirë **SFIDA “TË FSHEHURA”** si vështirësitë e shëndetit mendor dhe abuzimi në familje. Duket se ekziston **një kulturë heshtjeje rreth temave të vështira** në jetën familjare, gjë që e bën të vështirë për familjet të kërkojnë ndihmë dhe mbështetje.

“Ekziston, gjithashtu, edhe problemi me shëndetin mendor të prindërve, por kjo nuk është aq e dukshme. Është e fshehur.”

“Përpjekjet për vetëvrasje ... një nga arsyet është vështirësia ekonomike. Familjet nuk mund të përballojnë shpenzimet e nevojshme dhe kjo çon në tentativa të tilla. Një tjetër arsye është dhuna dhe abuzimi që burrat ushtrojnë ndaj grave dhe fëmijëve.”

“Ne punojmë me të rinj dhe fëmijë që abuzohen nga familjet e tyre. Gjithashtu, kemi disa fëmijë të cilëve familja u mohon të drejtën për të shkuar në shkollë, në mënyrë që të kujdesen për të afërm në nevojë. Po ashtu, kemi të rinj dhe fëmijë të mitur që detyrohen nga familjet e tyre të punojnë.”



MBËSHTETJE E NEVOJSHME PËR FAMILJET E CENUESHME

T'i njohësh çështjet e përgjithshme shoqërore është e rëndësishme, por të dish si të ofrosh mbështetje efektive është thelbësore. Në këtë pjesë, udhëheqësit e kishave diskutojnë llojet e ndihmës që, sipas tyre, u nevojiten fëmijëve, të rinjve dhe familjeve të cenueshme për të përparuar.

72%

24%

3%

A KUPTOJNË UDHËHEQËSIT E KISHËS SE PËR ÇFARË KANË NEVOJË FAMILJET/FËMIJËT E CENUESHËM NË LIDHJE ME MBËSHTETJEN PËR T'I FUQIZUAR?



Po



Pjesërisht



Nuk jam i sigurt

Udhëheqësit e kishave ndihen të sigurt se e kuptojnë mbështetjen që u nevojitet familjeve të cenueshme. Ata identifikuan lloje të ndryshme ndihme të nevojshme për të trajtuar probleme si varfëria dhe çështjet familjare.

Kur u pyetën të ndanin më shumë rreth llojeve të mbështetjes që, sipas tyre, u nevojiten fëmijëve, të rinjve dhe familjeve të cenueshme, shumica e udhëheqësve të kishave theksuan shumëllojshmërinë e sfidave me të cilat përballlet kjo kategori. Ata përmendën lloje të ndryshme mbështetjeje të nevojshme, duke përfshirë atë ekonomike, sociale, psikologjike dhe shpirtërore.

Shembuj të përgjigjeve të tyre të shumanshme:

"Ka nevoja bazë ushqimore për sigurimin minimal të jetesës mujore. [Ata] kanë nevojë për ndihmë në procesin e të mësuarit; për t'ju dhënë në mënyrë të vazhdueshme mesazhin e shpresës që jep ungjilli; si dhe për një figurë atërore, vëllazërore dhe mashkullore."

"1. Punësimi 2. Shkollimi/Edukimi 3. Ndërgjegjësimi për dhunën në familje 4. Fëmijët përfundojnë ciklin e ulët (9-vjeçar) dhe më pas shkojnë jashtë vendit për të punuar. 5. Ndërgjegjësimi për martesat e hershme (martohen në moshën 13-vjeçare)."

"Sipas mendimit tim, fuqizimi vjen përmes edukimit, sigurimit të strehimit dhe përfshirjes në komunitet (integritet shoqëror)."



Nga këto lloj përgjigjesh të detajuara, identifikuam pesë tema të përbashkëta që u shfaqën në shumë prej përgjigjeve. Më poshtë, kemi përmbledhur këto ide dhe kemi përfshirë disa thënie të drejtpërdrejta që ndihmojnë për t'i shqyrtuar më thellë.



TEMATIKA TË PËRBASHKËTA



MBËSHTETJA EKONOMIKE

Familjet e cënueshme shpesh përballen me sfida të mëdha financiare, kryesisht për shkak të papunësisë dhe pagave të ulëta. Për shumë prej tyre, varfëria e vështirëson përmbushjen e nevojave bazë. Udhëheqësit e kishave theksuan rëndësinë e ofrimit të ndihmës së

menjëhershme, si ushqim, veshje dhe mbështetje financiare, për të mbushur këto boshllëqe. Për stabilitet afatgjatë, ata theksuan nevojën për mundësi më të mira punësimi, planifikim financiar dhe paga më të larta për t'i vendosur familjet në një rrugë më të qëndrueshme ekonomike.

"Ne shikojmë papunësi dhe nevojë për ushqim e veshmbathje."

"Krijim i vendeve të punës. Mbështetje për të rritur mundësitë për vetëpunësim."

"Kemi qenë duke mbështetur disa familje me sende materiale ... por edhe duke i trajnuar për tregun e punës."



MBËSHTETJA ARSIMORE

Fëmijët nga familjet e cënueshme shpesh mungojnë në shkollë ose nuk kanë mbështetje arsimore në shtëpi. Udhëheqësit e kishave theksuan rëndësinë e programeve që promovojnë të mësuarit, parandalimin e analfabetizmit dhe arsimin e vazhdueshëm. Iniciativa

arsimore, si trajnimi i prindërve dhe programet pas-shkollore, mund të ndihmojnë fëmijët të kenë sukses në shkollë dhe të nxisin dëshirën për të mësuar.

"Arsimimi është një nevojë e madhe për komunitetin ku punojmë; dhe po ashtu është edhe trajnimi për prindërit lidhur me arsimimin e fëmijëve."

"Ata kanë nevojë për arsimim, pasi janë afër nivelit të analfabetizmit."

"Ka nevojë për trajnime në shkollën ku ne ofrojmë shërbime pas-shkollore dhe ndihmë për fëmijët që kanë vështirësi në shkollë."



MBËSHTETJA PSIKO-EMOCIONALE

Shumë udhëheqës të kishave theksuan nevojat e ndryshme emocionale, marrëdhënësore dhe psikologjike të grupeve të cënueshme. Ata theksuan rëndësinë

e sistemeve mbështetëse që promovojnë shëndetin mendor dhe mirëqenien emocionale. Ndërsa disa theksuan rolin e këshilltarëve profesionistë, të tjerë theksuan vlerën e marrëdhënieve të përditshme me dëgjues të besueshëm dhe empatikë. Në përgjithësi, kishte një

ndjeshmëri të qartë nga këta udhëheqës se nevojiten shumë lloje të ndryshme mbështetjesh psiko-emocionale.

"Ka nevojë për ndihmë psikologjike për fëmijët."

"Ata kanë nevojë për inkurajim, mbështetje financiare dhe shpirtërore, mirëbesim e ndonjëherë edhe disiplinë, në mënyrë që të njohin dhe të respektojnë njëri-tjetrin."

"Kanë nevojë të dëgjohen dhe t'i dëgjojnë."

"Integrim shoqëror dhe një model kujdesi për t'i dëgjuar dhe dashur ata."



MBËSHTETJA PRINDËRORE

Shumë nga sfidat që fëmijët përballen rrjedhin nga mungesa e mbështetjes, madje edhe prej abuzimit nga prindërit e tyre. Udhëheqësit e kishave identifikuan mbështetjen për prindërit si një mënyrë kyçe për të përmirësuar jetën e fëmijëve dhe të rinjve të cenueshëm. Kjo mbështetje do të përqendrohej në ndërtimin e aftësive dhe besimit tek prindërit, përmirësimin e dinamikave familjare dhe forcimin e praktikave të rritjes së fëmijëve. Duke rritur angazhimin dhe ndërgjegjësimin e prindërve për përgjegjësitë e tyre, ata do të pajiseshin më mirë për të krijuar mjedise mbështetëse për fëmijët e tyre.

"Prindërit nuk kalojnë kohë me fëmijët; fëmijët e kalojnë shumicën e kohës në rrjetet sociale."

"Më shumë vëmendje familjare për fëmijët ... Angazhimi më i madh është të përfshihesh në shoqëri."

"Është e nevojshme që prindërit të jenë të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë që kanë ndaj fëmijëve dhe që fëmijët të mësohen me modele më të mira sesa ato të rrjeteve sociale."



MBËSHTETJA SHPIRTËRORE

Mbështetja shpirtërore është thelbësore për të nxitur një ndjenjë komuniteti dhe përkatësie mes familjeve të cenueshme. Udhëheqësit e kishave theksojnë se fëmijët dhe të rinjtë e cenueshëm kanë nevojë jo vetëm për ndihmë materiale, por edhe për inkurajim shpirtëror. Ata veçanërisht kanë nevojë të përjetojnë dashurinë e Krishtit dhe të kuptojnë vlerën dhe rëndësinë e tyre në sytë e Tij.

"Pjesa shpirtërore është nevoja kryesore. Ne, gjithashtu, përqendrohemi në anën arsimore dhe shëndetësore përmes kurseve, fizioterapisë dhe terapive të ndryshme."

"Qëllimi ynë është që t'i drejtojmë ata me këshilla dhe shembuj drejt një jete të mbështetur tek Perëndia dhe jo aq shumë tek të tjerët."

"Misioni ynë si kishë nuk është vetëm të ofrojmë shërbime apo të mira materiale, por të ofrojmë mbështetje shpirtërore për t'u treguar dashurinë e Krishtit."

PARANDALIMI DHE NDËRHJRJA SIPAS KISHAVE


Pasi u kërkuam udhëheqësve të kishave të identifikonin fushat që kanë më shumë nevoja, dhe të reflektonin mbi mbështetjen ideale për familjet e cënueshme, shqyrtuam atë që kishat po bëjnë aktualisht përmes politikave dhe shërbesave të tyre. Qëllimi ynë ishte të vlerësonim praninë e politikave specifike që mbrojnë grupet e cënueshme, dhe të identifikonim fushat ku ka përputhje ose mungesa në mënyrën se si kishat po u përgjigjen nevojave të komunitetit të tyre.

A KA KISHA JUAJ NDONJË POLITIKË QË LIDHET POSAÇËRISHT ME MBROJTJEN E FËMIJËVE?

Për shembull, a keni trajnime për vullnetarët e shërbesës së fëmijëve, a keni protokolle për raportimin e gjërave shqetësuese që mund të vëzhgoni, etj.?

☒ Po


☐ Jo



Nga 55 kishat që kanë një politikë për mbrojtjen e fëmijëve, 41% përdorin politikën e rekomanduar nga Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë (VUSH).

Kishat në rajonin verior kanë shumë më pak prirje të thonë se kanë politika për mbrojtjen e fëmijëve të cënueshëm. Vetëm 36% u përgjigjen po ndaj kësaj pyetjeje, një përqindje shumë më e ulët se mesatarja. (Shih Shtojcën B)

Të kesh një politikë, sigurisht, nuk është e njëjta gjë me zbatimin e saj në praktikën e shërbesës. Kur pyetëm udhëheqësit e kishave se si po i zbatonin politikat e tyre për mbrojtjen e fëmijëve, përgjigjet ishin shumë të ndryshme. Nga 90 kishat e intervistuar, vetëm 11 thanë se e përdorin në mënyrë aktive politikën që kanë për t'i drejtuar në marrjen e vendimeve gjatë shërbesës.



SI DO TA PËRSHKRUANIT ROLIN E POLITIKËS QË KENI:

- ☒ 36 kisha – Nuk kemi
- ☐ 22 kisha – Kemi por nuk e përdorim rregullisht
- ☐ 19 kisha – I referohemi rregullisht
- ☐ 11 kisha – Përdoret rregullisht për të udhëzuar në zgjidhjet



MBËSHTETJA SPONTANE NGA ANËTARËT E KISHËS

Fëmijët dhe familjet në nevojë mund të jenë anëtarë të një kishë, por kjo nuk do të thotë se pjesëtarët e tjerë të kishës janë të vetëdijshëm për sfidat e tyre apo po përpiqen t'i ndihmojnë. Udhëheqësit e kishave ishin të bindur se shumica ose të gjithë anëtarët e kishës e njohin realitetin e familjeve që janë në kishë të cilat përjetojnë trauma ose vështirësi të tjera. Ata gjithashtu besonin se shumica e besimtarëve do të dëshironin të ndihmonin (64%) ose do të ishin të gatshëm të ndihmonin disi (29%).

Kur u pyetën **si** e shihnin mbështetjen nga anëtarët e kishës, përgjigjet më të zakonshme përfshinin ofrimin e ndihmës materiale, sigurimin e kujdesit emocional ose shpirtëror, angazhimin si vullnetarë në shërbesat e kishës dhe përpjekjen për të krijuar një mjedis gjithëpërfshirës dhe mikpritës.

ANËTARËT E KISHËS PËRBALLË SHËRBESAVE TË KISHËS

Anëtarët e kishës luajnë një rol kyç në shërbesat e kishës duke ofruar krahun e punës ose të mirat materiale që nevojiten për t'i realizuar ato. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohen dallimet midis mbështetjes së drejtëpërdrejtë që ofrohet nga anëtarët e kishës për familjet e cënueshme dhe mbështetjes që ofron kisha si institucion.

MBËSHTETJA E ANËTARËVE

Të përmendura më shpesh

Qëndrimi mikpritës dhe përfshirja në aktivitetet e kishës.

“Anëtarët e kishës përpiqen dhe kujdesen për t'i bërë pjesë të kishës.”

Mbështetje emocionale e shpirtërore nëpërmjet lutjes, këshillimit dhe inkurajimit.

“Duke i vizituar dhe duke u ofruar mbështetje shpirtërore dhe emocionale.”

Mbështetje materiale/dhurime si ushqim, veshmbathje dhe strehim.

Vullnetarizëm

Të përmendura më rrallë

Këshilla dhe ndihmë për nevoja praktike

“Ndihmë praktike (me punë të ndryshme).”

“Ofrim këshillash dhe idesh për jetën dhe nevojat e tyre shoqërore.”

MBËSHTETJA E KISHËS

Të përmendura më shpesh

Mbështetje me pako ushqimore.

Programe pas-shkollore.

Burime shpirtërore si literaturë, broshura, vizita, etj.

Të përmendura më rrallë

Shërbime këshillimi.

Shëndeti dhe rehabilitimi.

Shërbime si fizioterapi, terapi e të folurit, etj.

Mbështetje financiare/shpërndarje parash.

Programe për nevoja të veçanta/grupe të caktuara, duke përfshirë autizmin, verbërinë, etj.

Zhvillim aftësish për punësim.



SHËRBESAT E KISHËS DHE NDËRHJRJET

Fokusi i studimit tonë ishte tek roli i shërbesës së kishës në mbështetjen e fëmijëve, të rinjve dhe familjeve të cënueshme. Në këtë pjesë do të shqyrtojmë pyetje rreth numrit të personave që kisha u shërben. Kjo na ndihmon të kuptojmë më mirë shtrirjen e kishave në Shqipëri dhe të identifikojmë ato fusha të shërbesës që janë të mbështetura dhe ato të cilat kanë nevojë për më shumë vëmendje.

Të gjitha shifrat e mëposhtme bazohen në vlerësimet e dhëna nga udhëheqësit e kishave në momentin e intervistimit, dhe jo në rishikime sistematike të shërbesave apo lista frekuentimi.

SA FAMILJEVE TË CËNUESHME U SHËRBENI...

✓ **62 Janë përgjigjur** — **28 Nuk janë përgjigjur**

Udhëheqësit e kishave që nuk i dhanë përgjigje kësaj pyetjeje, mund të mos jenë duke i shërbyer asnjë familje në nevojë, për momentin.



Disa kisha u përgjigjën në disa kategori. Nuk kuptohet lehtë si fjalë! Sugjeroj të jetë - Tre nga përgjigjet "çdo javë" shërbejnë gjithashtu: njëra edhe "në baza mujore" dhe dy të tjera edhe "herë pas here". - Fjalët që kam vendosur në thonjëza mund të bëhen edhe me bold. Gjithashtu mendoj që në fillim të çdo fjalie numri të jetë me shkronja. Të ndiqet e njëjta logjikë si me fjalinë e parë. - Dhjetë përgjigje "çdo muaj" shërbejnë gjithashtu edhe "herë pas here". - Dyzet e nëntë përgjigje zgjodhën vetëm një kategori.


Familje të shërbyera
 Kisha të përfshira

SA FËMIJËVE/ TË RINJVE TË CËNUESHËM U SHËRBENI...

(NË PËRGJITHËSI, JO VETËM FËMIJË DHE TË RINJ QË VIJNË NË KISHË)

✓ **59 Janë përgjigjur** — **31 Nuk janë përgjigjur**

Udhëheqësit e kishave që nuk i dhanë përgjigje kësaj pyetjeje, mund të mos jenë duke i shërbyer asnjë familje në nevojë, për momentin.



Fëmijë/të rinj të shërbyer

Kisha të përfshira



Disa kisha u përgjigjën në disa kategori. Tre përgjigje çdo javë shërbejnë, gjithashtu, çdo muaj (1) ose herë pas here (2). Një përgjigje çdo muaj shërben, gjithashtu, herë pas here. Pesëdhjetë e pesë përgjigje zgjodhën vetëm një kategori.



SA FAMILJE TË CENUESHME MARRIN PJESË RREGULLISHT NË KISHËN TUAJ?

(janë anëtarë aktivë në komunitetin shpirtëror të bashkësisë suaj)

0-4 5-10 11 ose më shumë



SA FAMILJE TË CENUESHME JANË TË LIDHURA ME KISHËN TUAJ PËRMES SHËRBESAVE, BURIMEVE OSE PROJEKTEVE, POR NUK JANË ANËTARË AKTIVË?


0-4 5-10 11 ose më shumë

Kishat janë përgjithësisht të lidhura me më shumë familje të cenueshme përmes shërbesave sesa përmes bashkësisë së tyre.

NA TREGONI DISA NGA MËNYRAT SE SI, JU SI KISHË, MBËSHTESNI OSE FUQIZONI FAMILJET OSE FËMIJËT E CENUESHËM

(zgjidhni të gjitha që vlejné)

- 4 ose më shumë kategori
- 2-3 kategori
- 1 kategori
- Asnjë (3 udhëheqës kisha nuk zgjodhën asnjë kategori)



Udhëheqësit e kishave morën një listë me disa kategori mbështetjeje dhe ata zgjodhën ato kategori në të cilat kisha e tyre është e përfshirë. Gjashtëdhjetë e gjashtë përqind e udhëheqësve zgjodhën 4 ose më shumë kategori. Shumë prej tyre ndanë gjithashtu detaje rreth mënyrave të mbështetjes që ofrojnë, të cilat i kemi përmbledhur bashkë me disa citime të përzgjedhura për të theksuar temat kryesore.

96%

SHPËRNDARJA E NDIHMËS



Shpërndarja e ndihmës u referohej kryesisht pakove ushqimore dhe të mirave të tjera materiale, me frekuenca dhe metoda të ndryshme shpërndarjeje. Ndërsa disa kisha ofrojnë ndihmë rregullisht—si për shembull, çdo muaj—disa të tjera ofrojnë mbështetje në mënyrë të herëpashershme, në varësi të burimeve që kanë. U përmendën, gjithashtu, bashkëpunime me organizata si bankat ushqimore.

“Qëllimi ynë është të lehtësojmë barrën financiare tek familjet duke ofruar mbështetje bazë për qiranë, ngrohjen dhe materialet shkollore.”

“Ne mbështesim 70 deri në 80 familje çdo muaj me ushqime, veshje, detergjent, etj.”

81% - VIZITA NË FAMILJE



Disa nga vizitat në familje planifikohen dhe bëhen rregullisht, ndërsa të tjera bëhen në bazë të nevojave apo rrethanave të caktuara.

“Vizitojmë 5 deri në 10 familje çdo muaj. Interesohemi për fëmijët e familjen dhe lutemi.”

“Bëjmë vizita për t’i inkurajuar, për t’u lutur, etj.”

62% - MENTORIMI I FËMIJËVE DHE TË RINJVE.



Mentorimi zakonisht zhvillohet në takime një me një ose në grup, me fokus ofrimin e udhëzimeve, mbështetjes dhe inkurajimit.

“Janë 4 mentorë që takohen një herë në javë, qoftë individualisht ose në grupe.”

“Kam një grup fëmijësh me të cilët flas, i mësoj dhe i inkurajoj në fusha të ndryshme të jetës.”

46% - MBËSHTETJA PRINDËRORE



Mbështetja për prindërimin, kur ofrohet, ndodh zakonisht përmes takimeve të herëpashershme dhe komunikimeve joformale, më tepër sesa përmes programeve të strukturuar. Këto takime shpesh përqendrohen tek nënat ose zhvillohen brenda grupeve të grave.

“... veçanërisht nënat (që janë të vetme), gjithashtu kemi ndihmuar me pune praktike dhe me këshilla.”

“Ndonjëherë kemi bërë takime ku fokusi ka qenë prindërimi.”

42% - MBËSHTETJA FINANCIARE



Mbështetja financiare është e kufizuar dhe rast pas rasti, e përqendruar në nevojat specifike si qiraja, mbështetje për ilaçe, pagesë faturash mujore (energji, uje, etj.), më shumë sesa ndihmë me para në dorë.

“Fokusohemi tek fuqizimi i tyre ... jo duke u dhënë para, por duke u blerë materialet për të cilat kanë nevojë.”

“Shumë rrallë japim ndihmë financiare; vetëm në raste urgjente ose specifike, si probleme mjekësore apo qira.”

32% - MBËSHTETJA PSIKOLOGJIKE



Mbështetja psikologjike zakonisht nënkupton përkujdesje pastorale. Pak nga udhëheqësit përmendën referimin te profesionistët, zakonisht në kontekstin e traumës ose aftësisë së kufizuar.

“Kemi referuar raste pasi profesionalisht nuk mund ta bëj këtë si pastor.”

“... kemi mbajtur herë pas here trajnime me psikologë dhe psikiatër.”

“Kemi drejtuar dhe mbështetur njerëz për të shkuar te një qendër e krishterë për këshillim.”

27% - PROGRAME PAS-SHKOLLORE



Programet pas-shkollore përqendrohen në mësim shtesë dhe zhvillim, me seanca në lëndë si anglisht, matematikë dhe kimi. Programet zakonisht ofrohen nga 2 deri në 5 ditë në javë, por janë të kufizuara për shkak të mungesës së stafit dhe të vullnetarëve.

21% - VAKTET USHQIMORE



Mbështetja me vakte ushqimore mund të ofrohet nga 2 deri në 5 herë në javë, shpesh së bashku me aktivitete për fëmijë ose takime në komunitet. Vaktet zakonisht gatuhet nga anëtarët e kishës ose në bashkëpunim me organizata të ndryshme.

“Pas takimit me fëmijët, zakonisht ofrojmë edhe një vakt ushqimor për ta.”

“Gatuojmë vetë dhe ftojmë familjet e cënueshme.”

18% - TË TJERA



Lloje të tjera mbështetjeje përfshijnë mbështetjen shpirtërore, orientimin për punësim dhe aktivitete shoqërore. Disa nga udhëheqësit përmendën edhe ndihmën praktike si materiale shkollore, ndihmë për ngrohje dhe kujdes shëndetësor urgjent, si edhe aktivitete zbavitëse, si sporte, ekskursione dhe kurse falas në muzikë dhe gjuhë të huaja. Mbështetje e specializuar ofrohet ndonjëherë për familjet që përballen me aftësi të kufizuara, probleme me varësinë apo janë prindër të vetëm, shpesh përmes bashkëpunimeve me organizata vendore dhe ndërkombëtare.



PËRSHTATJET E SHËRBESËS DHE MOSPËRSHTATJET

Deri në këtë pikë të raportit, kemi mbledhur të dhëna nga udhëheqësit e kishave mbi ato që ata i shohin si nevojat më urgjente të familjeve të cënueshme në komunitetet e tyre. Ata, gjithashtu, ndanë këndvështrimin e tyre mbi llojet e mbështetjes që u nevojiten këtyre familjeve dhe përshkruan shërbesat dhe ndërhyrjet që kishat e tyre ofrojnë aktualisht.

Në këtë pjesë do të bëjmë një hap pas nga përgjigjet e studimit për të shqyrtuar disa tema që po dalin më në pah. Qëllimi ynë është të ofrojmë qartësi dhe të inkurajojmë diskutimin mbi mënyrën se si kishat në Shqipëri po ia dalin me sukses dhe ku mund të kenë mangësi në përballimin e nevojave të veçanta të fëmijëve dhe të rinjve më të cënueshëm.



PËRPJEKJE PËR T'U PËRGËZUAR

Ka disa fusha ku nevojat e familjeve të cënueshme po plotësohen nga mbështetja që ofrojnë kishat. Këto përpjekje duhen përgëzuar dhe thelluar, për të përforcuar kujdesin e kishave shqiptare për fëmijët dhe të rinjtë e cënueshëm.

Integrimi i komunitetit

Fëmijët, të rinjtë dhe familjet e cënueshme mund të ndihen të izoluar për shkak të turpimit ose paragjykit. Ata kanë nevojë të përjetojnë të vërtetën se për ta ka dashuri dhe se i përkasin komunitetit të tyre.

Kishat shqiptare mund të luajnë një rol kyç në plotësimin e kësaj nevoje. Shumë udhëheqës raportuan se bashkësitë e tyre ftojnë vazhdimisht fëmijë dhe të rinj të cënueshëm në aktivitetet e kishës. Aktivitetet sociale, përfshirja shpirtërore dhe mentorimi janë mënyra me të cilat kishat po integrojnë të rinjtë në jetën e komunitetit dhe po luftojnë ndjenjat e izolimit.

Ndërtimi i marrëdhënieve

Pavarësisht nga situata familjare, fëmijët kanë nevojë për mbështetje dhe inkurajim edhe nga të rritur të tjerë në jetën e tyre. Po ashtu, vlerësimi i jashtëm është veçanërisht i rëndësishëm për të rinjtë që përballen me mungesë mbështetjeje në shtëpi.

Kishat luajnë një rol kyç në ndihmën që u ofrohet të rinjve për të krijuar marrëdhënie me të rritur që kujdesen për ta jashtë familjes së tyre. Shumë udhëheqës kishash ndanë shembuj të ndërtimit të marrëdhënieve, duke filluar nga programet formale të mentorimit deri tek aktivitetet pas-shkollore që i lidhin të rinjtë me vullnetarë që kujdesen për ta.

Mbështetje emocionale për familjet

Sfidat që përballojnë familjet e cënueshme, si dhuna, varësia dhe uria, lënë plagë të thella emocionale. Njerëzit në këto situata kanë nevojë për inkurajim, dëgjim empatik dhe reagime pozitive. Kujdesi pastoral është një lloj mbështetjeje kyçe që po ofrojnë udhëheqësit e kishave. Nëpërmjet vizitave në shtëpi, lutjes dhe duke qenë të gatshëm për të dëgjuar, pastorët dhe anëtarët e tjerë të kishës konfirmojnë vlerën e individëve dhe ofrojnë mirësi për ata që po përjetojnë dhimbje.

Mbështetje për nevojat themelore

Fëmijët dhe të rinjtë e cënueshëm shpesh përballen me nevoja materiale që e bëjnë jetën më të vështirë, si uria, mungesa e rrobave ose një shtëpi pa ngrohje gjatë dimrit. Kishat mund të luajnë një rol kyç në adresimin e këtyre nevojave themelore. Paketat ushqimore dhe shërbesat e herëpashershme me vakte ushqimore ndihmojnë në plotësimin e nevojës për t'u ushqyer, ndërsa ndihma financiare për kujdesin mjekësor urgjent ose ngrohjen gjatë dimrit mund të zgjasë burimet e kufizuara të familjeve.

Edhe pse shumë udhëheqës theksuan kapacitetin e kufizuar të kishave të tyre për të ofruar mbështetje konkrete, ishte inkurajuese të shihje dëshirën dhe angazhimin e tyre që, sa herë kanë mundësi, ofrojnë materiale për të krijuar një lloj "rehatie" bazë për më të cënueshmit.

SHQYRTOJMË MOSPËRSHTATJEN

Kemi vënë re disa fusha ku nevojat e familjeve të cënueshme janë më të mëdha sesa mbështetja që po ofrojnë kishat. Shpresojmë që kishat shqiptare të konsiderojnë këto fusha kyçe si mundësi për rritje dhe shërbesë më të thellë.

Sfidat ekonomike dhe punësimi

Ka një dakordësi të gjerë se sfidat ekonomike janë në thelb të shumë problemeve me të cilat përballen fëmijët dhe familjet e cënueshme. Disa kisha ofrojnë ndihmë materiale, si paketa ushqimore, furnizime bazë dhe ndihmë financiare herë pas here, por kapaciteti i tyre për t'i mbështetur këto programe është i kufizuar.

Adresimi i nevojave të menjëhershme ndihmon në afat të shkurtër, por në fund, janë të nevojshme mundësi më të mira punësimi për qëndrueshmërinë afatgjatë. Udhëheqësit e kishave mund të jenë të vetëdijshëm për këtë, por ekziston një hendek në aftësinë e tyre për të ndihmuar me këto sfida të ndërlikuara. Shumë pak kisha kanë përmendur iniciativa që lidhen me punësimin ose trajnimet për punë, megjithëse i kanë njohur këto si nevoja kyçe më herët në studim.

Partneritetet me OJQ-të, institucionet publike dhe programet qeveritare mund të nxisin përmirësime të mundshme në këtë fushë në të ardhmen.

Abuzimi dhe mbështetja psikologjike

Udhëheqësit e kishave shpesh e identifikuan dhunën, mosfunksionimin familjar, dhe abuzimin me substanca, si çështje kritike me të cilat përballen komunitetet e cënueshme. Ndërkohë që disa aktivitete të kishës i adresojnë indirekt këto sfida duke ofruar mbështetje emocionale dhe komunitare, pak iniciativa i trajtojnë ato drejtpërdrejt.

Mbështetja psikologjike ishte ndër shërbimet më të pakta që ofroreshin nga kishat. Kur ofrohet, shpesh përqendrohet te shërbimet për aftësitë e kufizuara, më shumë sesa te trauma ose abuzimi. Na bëri përshtypje se sa të paktë janë udhëheqësit që thanë se po marrin masa për të adresuar sfidat “e fshehura” të abuzimit familjar, dhunës në familje dhe vështirësive të shëndetit mendor.

Edhe pse këto janë tema delikate, ne e shohim këtë hapësirë si një mundësi për kishat që të ndërmarrin hapa më të guximshëm, të qëllimshëm dhe të drejtpërdrejtë për të adresuar çështjet e dhunës në familje dhe të kulturës së abuzimit.

Mbështetje e plotë për fëmijën

Ndërsa disa kisha ofrojnë programe pas-shkollore dhe shërbime arsimore, intervistat tona theksuan nevojën për të vënë në qendër mirëqenien e përgjithshme të fëmijëve. Kjo përfshin adresimin e çështjeve psikologjike dhe nevojave më të gjera zhvillimore si marrëdhëniet me bashkëmoshatarët, lidhja emocionale, edukimi seksual i përshtatshëm me moshën dhe objektivat për të ardhmen. Edhe pse kjo mund të duket si një detyrë sfiduese, një përpjekje komunitare ku secili kontribuon, mund të sjellë ndryshim.

Mbështetja për fëmijët e cënueshëm kërkon më shumë sesa plotësimin e nevojave të jashtme; ajo përfshin krijimin e hapësirave të sigurta ku mund të shërohen plagët më të thella. Kjo qasje kërkon marrëdhënie të bazuara në besim, programe kreative dhe një të kuptuar të ndikimit që ka trauma. Të adresosh këtë boshllëk është sfiduese, por nga ana tjetër ofron një mundësi me shumë kuptim që kishat të zgjerojnë ndikimin e tyre.

Mbështetje për prindërimin

Shumë udhëheqës kishash shprehën shqetësimin për mungesën e ndërgjegjësimin të prindërve në lidhje me nevojat emocionale, psikologjike dhe zhvillimore të fëmijëve të tyre. Kjo lloj mungese ishte një prire shkurajuese që u vu re në shumë intervista me udhëheqësit e kishave.



Megjithatë, vumë re se më pak se gjysma e kishave raportuan se kishin programe të dedikuara për mbështetjen e prindërimit. Shumica e këtyre përpjekjeve ishin të paqëndrueshme ose joformale, shpesh të kufizuara në takime të herëpashershme apo këshilla, kryesisht të drejtuara ndaj nënave.

Ndërsa udhëzimi joformal për prindërimin ka vlerën e vet, ekziston një nevojë e qartë për mbështetje më të qëllimshme dhe të mirëorganizuar për prindërit e familjeve të cënueshme. Zhvillimi i programeve të strukturuar për prindërimin, veçanërisht ato që u drejtohen çështjeve specifike me të cilat përballen të rinjtë e cënueshëm, mund të forcojë marrëdhëniet familjare dhe të ndihmojë në zvogëlimin e problemeve që prekin fëmijët dhe të rinjtë.

Programet për abuzimin me substanca

Abuzimi me substanca është një çështje veçanërisht shqetësuese, por e trajtuar në mënyrë të pamjaftueshme. Udhëheqësit e kishave e identifikuan abuzimin me substanca nga prindërit si një shqetësim të madh dhe një sfidë kritike për familjet e cënueshme.

Problemi njihet, por mbështetja mungon. Shumica e kishave nuk kanë programe formale trajtimi për abuzimin me substanca apo ndërhyrje të posaçme për familjet e prekura nga varësia. Ndërsa mund të ofrohet mbështetje joformale përmes këshillimit ose kujdesit pastoral, mungesa e programeve të gjera dhe të strukturuar thekson një boshllëk kritik në adresimin e kësaj çështjeje.

Rritja e ndërgjegjësimit dhe puna për të hequr stigmatizimin e abuzimit me substanca brenda komuniteteve të kishës mund të inkurajojë, gjithashtu, një dialog më të hapur dhe të krijojë mundësi për ndërhyrje më efektive.



SHËRBESA ME FËMIJËT PA KUJDES PRINDËROR

Ndërsa shumë fëmijë dhe familje përballen me një sërë sfidash, fëmijët që janë privuar nga kujdesi prindëror ose që janë ndarë nga kujdestarët e tyre kryesorë, shpesh përballen me vështirësi shtesë ose kanë nevojë për lloje të ndryshme mbështetjeje. Në hyrjen e raportit, ndamë tre situata të ndryshme që mund të çojnë në privimin e një fëmije apo të riu nga kujdesi prindëror.

- **Jetim biologjik:** Ka humbur njërin ose të dy prindërit.
- **Jetim social:** E kanë larguar nga shtëpia dhe e kanë vendosur diku tjetër për shkak të rrethanave familjare.
- **Jetim në shpirt:** Ka kujdestarë, por i mungon mbështetja emocionale.

*“Ata jetojnë për
të mbijetuar.”*

- Pastor



Pjesa më e madhe e udhëheqësve të kishave (70%) thanë se i njohin këto përkufizime të llojeve të ndryshme të jetimëve. Më pak (30%) thanë se këto ide ishin të reja për ta.

POTHUAJSE TË GJITHË UDHËHEQËSIT E KISHAVE (93%) THANË SE DO TË DËSHIRONIN MË SHUMË INFORMACION OSE TRAJNIME NË LIDHJE ME KËTO TEMA.



E DIELA E JETIMËVE

Për më shumë se 20 vjet, kishat nga e gjithë bota janë bashkuar çdo vit në të dielën e dytë të nëntorit, për të tërhequr vëmendjen ndaj zemrës së Perëndisë për jetimët dhe fëmijët e familjet e cënueshme. Kjo ngjarje është një mundësi për të ftuar bashkësitë lokale që të përgjigjen në mënyra të thella dhe kuptimplota.

E Diela e Jetimëve është një nismë nga anëtarët e Aleancës së Krishterë për Jetimët (CAFO). Projekti ka për qëllim të frymëzojë dhe pajisë popullin e Perëndisë për të jetuar "fenë e pastër" të përshkruar në librin e Jakobit dhe të propozuar nëpërmjet Shkrimeve të Shenjta. Shqipëria Pa Jetimë ka promovuar këtë ngjarje të veçantë që nga viti 2020, duke ofruar materiale, ide dhe duke ftuar kishat që ta organizojnë atë në mënyrën e tyre.


A KENI DËGJUAR PËR **TË DIELËN E JETIMËVE** APO A KENI ORGANIZUAR DIÇKA NË ATË DITË VITET E MËPARSHME?




Po



Jo




Ndërgjegjësimi për të Dielën e Jetimëve ndryshon shumë nga njëri rajon në tjetrin. Udhëheqësit e kishave në veri dhe jugperëndim duket se janë përgjithësisht të njohur me këtë ngjarje:



Mbi 70% e udhëheqësve në të dy rajonet thanë se ishin të njohur me këtë ngjarje. Në kontrast, më pak se 50% e udhëheqësve në rajonet qendrore dhe juglindore thanë se e dinin se çfarë ishte. Udhëheqësit e kishave në kryeqytet janë më pak të njohur me këtë ngjarje.


VETËM 44% THANË SE E DININ PËR TË, KRAHASUAR ME 60% TË UDHËHEQËSVE NË ZONAT URBANE DHE 71% TË UDHËHEQËSVE NË ZONAT RURALE.

(shih Shtojcën B)



NËSE PO, A KENI ORGANIZUAR DIÇKA NË ATË DITË NË VITET E KALUARA?

Përgjigje gjithsej: 51



NËSE PO, A MUND
TË NA TREGONI
SE ÇFARË KENI
ORGANIZUAR?

19

Shërbesa të kishës
dhe/ose predikime
me këtë fokus

9

Lutje

LLOJET E
AKTIVITETEVE

17

Ndërgjegjësim
dhe ndarje
informacioni

6

Dhurata
materiale ose
financiare

PËRKUJDESJA PËR JETIMËT

A i mbështet kisha juaj ose ndonjë anëtar i kishës fëmijët pa kujdes prindëror (për shembull si familje kujdestare, familje birësuese, jetimore/ shtëpi-familje, të përfshirë në jetimore)?




Po



Jo



Nuk jam i sigurt



Kishat në veri janë më pak të prirura të raportojnë se anëtarët e tyre mbështesin fëmijët pa kujdes prindëror (29% thanë po, krahasuar me 49% gjithsej). Shumë udhëheqës të kishave në zonat rurale thanë se nuk janë të sigurt nëse kjo lloj mbështetjeje po ndodh në kishat e tyre (43% të pasigurt).

(shih Shtojcën B)

NËSE PO, ÇFARË JANË DUKE BËRË?

Katër temat e mëposhtme tregojnë përgjigjet ndaj kësaj pyetjeje. Megjithatë, në aspektin e shifrave, ato përbëjnë vetëm **rreth 20 përgjigje**, çka përfaqësojnë më pak se çerekun e mostrës totale. Është inkurajues të dimë se ka familje të krishtera që angazhohen në kujdesin për jetimët; prapëseprapë, kjo pamje vlen vetëm për numrin e vogël të familjeve që janë përfshirë në këtë raport.



x5

FAMILJET
KUJDESTARE OSE
BIRËSUESE NË KISHË
Pak anëtarë të kishës

marrin pjesë në mënyrë aktive në kujdestarinë për fëmijët, si në mënyrë formale ashtu edhe joformale. Disa familje birësojnë, ndërsa të tjera angazhohen në kujdes të përkohshëm ose emergjent për fëmijët gjatë fundjavës.



x6

MENTORIMI OSE
MBËSHTETJA
INDIVIDUALE PËR
JETIMËT

Në disa komunitete kishash, jetimët marrin mentorim, këshillim dhe mbështetje shpirtërore. Disa mund të marrin ndihmë financiare për arsimim, ushqim dhe nevoja të tjera thelbësore.



x5

AKTIVITETE ME DHE PËR FËMIJËT QË JETOJNË NË SHTËPI FËMIJËSH

Disa anëtarë të kishës organizojnë aktivitete të rregullta për fëmijët në shtëpi fëmijësh, përfshirë sporte, festa dhe mentorim. Gjithashtu ka anëtarë që ofrojnë mbështetje individuale për fëmijët në shtëpitë e fëmijëve lokale.



x6

MBËSHTETJE PËR FAMILJET QË KUJDESEN PËR JETIMËT (kur kujdesen familjarët ose njëri prind)

Disa komunitete kishash mbështesin familjarët që janë kujdestarë dhe familjet me një prind. Kjo mund të përfshijë si sigurimin e anës materiale ashtu edhe mbështetjen morale. Anëtarët e kishës mund të ndihmojnë anëtarët e familjeve të fëmijëve që kujdesen për fëmijët.

Ë MENDONI SE ANËTARËT E KISHËS DO
TË ISHIN TË INTERESUAR TË BËHESHIN
FAMILJE KUJDESTARE OSE BIRËSUESE OSE
TË MËSOJNË MË SHUMË RRETH KËSAJ?




Nuk jam i sigurt



Po



Jo



Kjo paraqet çka mendojnë pastorët për anëtarët e kishës së tyre, jo të dhëna të drejtpërdrejta nga vetë anëtarët e kishës.

Fëmijët që nuk kanë kujdes prindëror përballen me sfida të mëdha, të cilat shpesh kërkojnë mbështetje të veçantë dhe të qëllimshme nga komunitetet e tyre. Udhëheqësit e kishave përgjithësisht i kuptojnë kategoritë e jetimëve biologjikë, socialë dhe shpirtërorë, por shprehin **dëshirën për më shumë trajnim dhe burime mbi këtë temë**. Ndërsa disa kisha janë të angazhuara në mënyrë aktive në kujdestari të fëmijëve, birësim apo mbështetje të shtëpive të fëmijëve, këto përpjekje përfaqësojnë vetëm një numër të vogël kishash të intervistuar. Shumë udhëheqës kishash besojnë se ka potencial për më shumë familje që të përfshihen në kujdesin ndaj jetimëve, megjithëse nuk janë të sigurt për nivelin e interesit që mund të kenë anëtarët e kishës.

PYETJE PËR T'U KONSIDERUAR

- Si mund t'i pajisin më mirë kishat anëtarët e tyre për të kuptuar dhe adresuar nevojat e fëmijëve pa kujdes prindëror?
- Çfarë i pengon anëtarët e kishës të përfshihen në kujdestari ose në birësim, dhe si mund të adresohen këto?
- Si mund të zgjerohen fushatat e ndërgjegjësimit si E Diela e Jetimëve në mënyrë që të arrihen më shumë zona apo komunitete?


INTEGRIMI I UNGJILLIT

Kjo pjesë shqyrton rolin e Shkrimit dhe të ungjillit në përpjekjet e shërbesave të kishave. Shpesh, **fëmijët e cënueshëm kanë nevojë të angazhohen me Biblën në mënyra që shkojnë përtej predikimit bazë**. Shërbesat mund të kenë nevojë të eksplorojnë metoda dhe qasje të ndryshme për t'i ndihmuar ata të lidhen me ungjillin.

Udhëheqësit e kishave që ne intervistuar, pohuan në shumicë dërrmuese se punojnë që ta integrojnë ungjillin në programet e tyre. Ky theksim është qartësisht i rëndësishëm për ta dhe pjesë e mënyrës se si ata e kuptojnë qëllimin e shërbesës së tyre. Ndërsa folën për mënyrën se si kjo duket në praktikë, ata theksuan disa strategji që përfshijnë:

- Shpërndarje materialesh ungjillizuese si Bibla dhe literaturë të krishterë
- Ndërthurja e lutjes dhe inkurajimit shpirtëror në programe
- Paraqitja e ungjillit në mënyrë krijuese, përmes historive dhe skeçeve

ÇFARË BURIMESH OSE MJETESH PËRDORNI PËR TË NDARË FJALËN E PERËNDISË DHE PËR T'I NDIHMUAR FËMIJËT TË ANGAZHOHEN?




KISHAT NË ZONA RURALE (100%) raportuan se përdorin vetëm materiale që i kanë blerë ose që u janë dhënë.

KISHAT NË VERI (21%) ishin të prirura të krijojnë ose përkthejnë materialet e tyre.



MATERIALET QË BLEJMË OSE MARRIM NGA BURIME FALAS

Këto janë disa burime dhe mjete specifike që përdorin kishat për të ndarë Shkrimin me fëmijët.




Përgjigje të tjera përfshijnë:

- Asambleja e Perëndisë
- OM
- Jeta Plus
- Royal Rangers
- SHKBSH
- ICF
- ZGG

A PËRDORNI NDONJË BURIM TË PËRSHTATUR PËR TË ARRITUR ME FJALËN E PERËNDISË, FËMIJËT/TË RINJTË E CENUESHËM?

☒ Po ☐ Jo ☐ Nuk jam i sigurt



Pas shqyrtimit të këtyre gjetjeve, kuptuam se kjo pyetje mund të ishte formuluar më qartë. Shumë udhëheqës kishash duket se u përgjigjën duke pasur parasysh shërbesën e përgjithshme të fëmijëve, në vend që të fokusohen në mënyrë specifike te burimet për fëmijët dhe të rinjtë e cenueshëm.

Për shembull, kur pyetëm për mjete apo materiale specifike që përdorin, përgjigjet përfshinin:

- Përdorim të mjeteve vizuale si video, kukulla apo imazhe.
- Përdorim të qasjeve ndërvepruese si muzika, lojrat, punëdore ose shembuj praktikë.
- Ndërtimi i marrëdhënieve me fëmijët.
- Përshtatja ose hulumtimi i materialeve të përshtatshme për grupmosha të caktuara.

Edhe pse janë të vlefshme, këto përgjigje shpesh u referoheshin fëmijëve në përgjithësi, në vend që të përqendroheshin posaçërisht te fëmijët e cenueshëm, dhe disa ishin më tepër mbështetëse në mënyrë të përgjithshme, sesa të drejtuara qartë drejt ndarjes së ungjillit. Këtu shohim një mundësi për të zhvilluar burime më të fokusuara, që adresojnë nevojat unike të fëmijëve dhe familjeve të cenueshme në Shqipëri, duke integruar njëkohësisht mesazhin e ungjillit. Kjo mund të përfshijë përkthimin dhe përshtatjen e burimeve ekzistuese për njerëz të cenueshëm nga kontekste të tjera në mbarë botën.



BURIME DHE PARTNERITETE


Kjo pjesë përqendrohet te burimet që kishat kanë ose do të dëshironin të kishin për të ndihmuar fëmijët dhe familjet e cenushme. Do të shqyrtojmë burimet njerëzore dhe partneritetet.

TRAJNIMI DHE VULLNETARËT

Disa nga burimet më të rëndësishme të një kishë janë njerëzit që e mbajnë atë në funksion. Kjo përfshin si stafin e paguar, ashtu edhe vullnetarët. Dëshëm të shihnim se si udhëheqësit e kishave i vlerësonin trajnimet, aftësitë dhe kapacitetin e njerëzve të tyre.


Shumë udhëheqës kishash duket se u janë përgjigjur pyetjeve më poshtë duke pasur në mendje shërbesën e fëmijëve në përgjithësi dhe nuk janë fokusuar te ndonjë trajnim i specifik për punën me fëmijë të cenushtëm.

A besoni se punonjësit ose vullnetarët tuaj janë të pajisur mirë **ME NJOHURITË DHE AFTËSITË PRAKTIKE TË NEVOJSHME** për t'u shërbyer fëmijëve/të rinjve të cenushtëm?




UDHËHEQËSIT E KISHAVE NË ZONAT RURALE KANË MË PAK GJASA TË NDIHEN SE PUNONJËSIT E TYRE JANË TË PËRGATITUR MIRË (VETËM 14% U PËRGJIGJËN PO), NDËRSA UDHËHEQËSIT E KISHAVE NË VERI JANË MË TË SIGURT (57% U PËRGJIGJËN PO).

(shih Shtojcën B)



SI DHE/PSE JANË
PUNONJËSIT/VULLNETARËT
TUAJ TË PËRGATITUR PËR
T'U SHËRBYER FËMIJËVE/TË
RINJVE TË CENUESHËM?
(zgjidhni të gjitha që vlejné)


- 65 – Trajnime të mëparshme**
- 50 – Përvojë nga jeta e vet**
- 46 – Arsimim profesional ose akademik**
- 3 – Tjetër**



Përgjigje të tjera:

- Përpara se t'u besojmë një shërbesë, i kemi testuar në shërbesa.
- Orientime dhe aftësim në kishë sipas nevojës.
- Shkollë biblike

ÇFARË TRAJNIMESH KANË MARRË? KUSH E
KA OFRUAR ATË? (ZGJIDHNI TË GJITHA QË VLEJNË)



Përgjigje gjithësej: 59

Kur bëhej fjalë për funksionimin e shërbesave të tyre, shumica e udhëheqesve thanë se si anëtarët e kishës ashtu edhe stafi janë të përfshirë. Disa përmendën edhe vullnetarë që mund të mos jenë anëtarë të kishës. Kishat në jugperëndim janë shumë më pak të prira të mbështeten te **STAFI I KISHËS (36%)** dhe më shumë të prira të përdorin **ANËTARËT E KISHËS PËR TË MENAXHUAR SHËRBESE** (91%).

Lidhur me llojet e burimeve që kishat po i kushtojnë shërbesës për familjet e cenueshme, burimi më i zakonshëm i përdorur janë fondet e posaçme (75%). Vlera monetare që ndahen nga buxheti i kishës, dhe hapësirat fizike u përmendën gjithashtu nga më shumë se gjysma e të intervistuarve.



PARTNERITETE

Gjatë këtij raporti kemi vënë re se sfidat me të cilat përballen fëmijët, të rinjtë dhe familjet e cënueshme në Shqipëri, janë komplekse dhe me shumë shtresa. Një mënyrë se si kishat mund të punojnë brenda burimeve të tyre të kufizuara, është përmes partneriteteve me kishat e tjera, OJQ-të, ose autoritetet lokale.

Pjesa më e madhe e udhëheqësve të kishave thanë se punojnë me partnerë të ndryshëm për të mbështetur familjet e cënueshme.

A PUNONI ME NDONJË PARTNER PËR TË NDIHMUAR NË ADRESIMIN E NEVOJAVE TË FAMILJEVE TUAJA NË NEVOJË?
(ZGJIDHNI TË GJITHA QË VLEJNË)

58 – OJQ

34 – Kishat e tjera

33 – Autoritetet lokale

4 – Të tjera

Përgjigje totale: 75

Katër përgjigje të tjera përfshinin:

- Tre(3) që përmendën individët
- Një(1) që punon me bizneset lokale për të ndihmuar në sigurimin/gjetjen e punës

Kishat në juglindje janë shumë më të prirura (90%) se ato në rajone të tjera të thonë se punojnë me autoritetet lokale. **Kishat rurale (57%) gjithashtu kishin më shumë mundësi të bashkëpunonin me autoritetet sesa kishat urbane.** (shihni Shtojcën B)

A JANË NË DIJENI AUTORITETET
LOKALE PËR PUNËN QË BËNI?




Po



Jo



I pasigurt



A KENI NJË MARRËVESHJE TË ZYRTARIZUAR ME
AUTORITETET LOKALE?




Po



Jo



I pasigurt



81% e udhëheqësve të kishave që thanë se autoritetet lokale janë të informuara për punën që po bëjnë, NUK kishin një marrëveshje formale me to.

82% që punojnë me autoritetet lokale thanë gjithashtu se nuk kanë një marrëveshje formale.

NEVOJAT E KISHAVE

Përgjigjet e fundit në studimin tonë u përqendruan në identifikimin e nevojave kryesore që udhëheqësit e kishave në Shqipëri shohin për shërbesën e tyre ndaj fëmijëve të cënueshëm. Përgjigjet e tyre ofrojnë njohuri të vlefshme për çdo individ që dëshiron të mbështesë kishat në mënyrë më strategjike dhe efektive për të arritur disa nga grupet më të cënueshme të shoqërisë.

CILAT JANË **NEVOJAT TUAJA MË TË MËDHA** PËR SHËRBESËN NDAJ FAMILJEVE TË CËNUESHME DHE/OSE FËMIJËVE/TË RINJVE ME TRAUMA?

ZGJIDHNI DY PËRPARËSITË KRYESORE.



TRAJNIME PËR VULLNETARËT DHE/OSE STAFIN

42%

37 KISHA

RRJETËZIMI ME TË TJERËT QË BËJNË TË NJËJTËN GJË

39%

35 KISHA

MË SHUMË VULLNETARË DHE/OSE STAF

34%

30 KISHA

MATERIALE OSE KURRIKULË ME PËRMBAJTJE MË TË MIRË

27%

24 KISHA

NJË MODEL I MIRË SHËRBESE OSE PROGRAMI

22%

20 KISHA

NDËRGJEGJËSIMI DHE VIZIONI PËR PËRPARËSINË E SHËRBESE ME FËMIJËT DHE TË RINJTË E CËNUESHËM

17%

15 KISHA

BASHKËPUNIMI ME AUTORITETET LOKALE

7%

6 KISHA

TË TJERA (JU LUTEMI PËRSHKRUANI)

7%

6 KISHA

Për shkak se pjesëmarrësit mund të zgjidhnin dy përgjigje, totali kalon 100%.)



TË THELLOHEMI MË SHUMË

Disa udhëheqës kishash ofruan detaje shtesë për kategori të caktuara. Ndërsa jo të gjitha përgjigjet shtuan informacion të ri, më poshtë janë disa që e bënë.

TRAJNIME PËR VULLNETARËT DHE/OSE STAFIN

- Të mësojmë si të identifikojmë fëmijët e abuzuar dhe të braktisur
- Ndihmë për të adresuar varësinë nga teknologjia dhe sigurinë në internet
- Komunikim dhe trajnim më i mirë për parandalimin e dhunës në familje
- Tema që përfshijnë: bullizmin, traumën, autizmin, higjienën dhe punën në grup



NJË MODEL I MIRË SHËRBESE OSE PROGRAMI

- Modele të përshtatura sipas kontekstit të tyre
- Rinovimi i ideve në punën e përditshme të shërbesës
- Inovacioni dhe krijimi i një mjedisi përfshirës




TË TJERA (JU LUTEMI PËRSHKRUANI)

- Burime financiare/Mbledhja e fondeve
- Personat me thirrje dhe pasion për këtë shërbesë
- Përkrahje profesionale për shërbesën që ofrojmë
- Bashkëpunimi me institucione arsimore
- Legjislacioni
- Hapësirë fizike
- Të dimë çfarë të bëjmë nëse dyshojmë se një fëmijë jeton në një situatë të vështirë



PYETJE PËR REFLEKTIM DHE DISKUTIM

Ky raport ka për qëllim të frymëzojë biseda dhe të nxisë ndryshime të rëndësishme për udhëheqësit e kishave shqiptare dhe të tjerë që kujdesen për mirëqenien e fëmijëve dhe familjeve të cënueshme. Të dhënat e paraqitura këtu nuk janë përfundimi i historisë, por një pikënisje për diskutime më të thella dhe ide inovative për përparim. Ndaj edhe kjo pjesë përfundimtare nuk ofron rekomandime ose udhëzime, por ngre pyetje për reflektim, diskutim dhe bashkëpunim.



PËR UDHËHEQËSIT E KISHAVE

Është e rëndësishme të festojmë gjërat e mira që po ndodhin në komunitetin tuaj, që ato mund të zgjerohen dhe të qëndrojnë të forta. Theksuam disa modele dhe pika të forta që pamë në të dhënat, siç janë **integrimi i komunitetit, mbështetja emocionale, dhe gatishmëria për të ndihmuar** në plotësimin e boshllëqeve në nevojat bazë për familjet e cënueshme.

- Cilat pika të forta dëshironi të festoni dhe forconi në komunitetin e kishës suaj?
- A ka një person apo skuadër që dëshironi të përmendni për punën e mirë që po bëjnë? Si mund ta bëni këtë në një mënyrë të përshtatshme që t'i inkurajoni ata?

NDËRSA SHUMË KISHA KANË NDONJË LLOJ
POLITIKE PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE (61%),
VETËM NJË PËRQINDJE E VOGËL E PËRDORIN
ATË NË MËNYRË AKTIVE PËR TË UDHËHEQUR
VENDIMET (13%).



- Cilat janë barrierat që e pengojnë kishën tuaj të zbatojë një politikë të fortë për mbrojtjen e fëmijëve?
- Si mund ta përmirësojë ose forcojë në mënyrë konkrete angazhimi më aktiv me ډیڤا të tillë shërbesën tuaj për fëmijët dhe të rinjtë e cënueshëm?



Raporti zbuloi një motiv të qartë: udhëheqësit e kishave shpesh identifikuan **rrënjët e dinamikave familjare** si faktorin kryesor të sfidave të fëmijëve, megjithatë diskutimet mbi mbështetjen u përqendruan kryesisht te ndërhyrjet për vetë fëmijët. Kjo sugjeron një **hendek të mundshëm** midis adresimit të shkaktarëve kryesorë, shpesh të lidhur me rrethanat familjare, dhe ofrimit të burimeve shtesë si programet edukative ose marrëdhëniet brenda kishës.

- A reflekton ky motiv atë që keni vënë re në komunitetin tuaj?
- Nëse po, çfarë mendoni se e shkakton këtë përqendrim te ndërhyrjet për fëmijët, në vend të zgjidhjeve që përqendrohen te familja?

- Si mund të përvetësojë kisha dhe komuniteti juaj një qasje më holistike, që adreson nevojat thelbësore të fëmijëve të cënueshëm dhe familjeve të tyre?
- Cilët hapa praktikë mund të ndërmerri për të forcuar dhe mbështetur familjet brenda sferës suaj të ndikimit?



Një nga hendekët kryesorë që identifikua midis nevojave dhe mbështetjes aktuale, ishte rëndësia jetike **e mundësive më të mira për punësim dhe trajnime**. Ndërsa trajnimi profesional nuk është thirrja e Kishës, na lind pyetja nëse mund të ofrohet më shumë vëmendje dhe energji nga kishat në këtë fushë.

- Çfarë mendoni për këtë ide? A është interesante për ju? E tepruar? Përtej mundësive tuaja? Kaloni disa minuta duke reflektuar mbi ndjenjat tuaja dhe duke shqyrtuar arsyet për këtë.
- A njihni ndonjë organizatë që po punon në këtë fushë, me të cilën ju ose kisha juaj mund të bashkëpunoni dhe mbështetni?

Një nga momentet më të ndjeshme në raportin tonë ishte mospërputhja në lidhje me **abuzimin dhe mbështetjen psikologjike**. Sugjeruam që udhëheqësit e kishave mund ta shohin këtë si një mundësi për të ndërmarrë hapa më të guximshëm, të qëllimshëm dhe të drejtpërdrejtë për të adresuar çështje si dhuna në familje dhe kultura e abuzimit.



- A jeni të vetëdijshëm për ndonjë situatë ose familje në rrethin tuaj që mund të përballen me këtë hendek? A ka fëmijë ose të rinj që mund të përjetojnë abuzim ose dhunë, por që ende nuk janë njohur nga anëtarët ose udhëheqësit e kishës së tyre?
- Si mendoni se si mund të ndihen ata kur udhëheqësit e kishës së tyre heshtin në lidhje me situatën e tyre?
- Cilat mendoni se janë pengesat për t'i nxjerrë më shumë në dritë këto çështje "të fshehura"?



Rreth gjysma e kishave që kemi intervistuar, thonë se dikush në kishën e tyre po ofron **mbështetje për fëmijët pa kujdes prindëror**. Kjo mund të marrë shumë forma, nga familje kujdestare, aktivitete në shtëpinë e fëmijës, deri tek mentorimi i fëmijëve jetimë.

- A ju befason ky numër? A është më i lartë apo më i ulët nga sa prisnit? Pse?
- Çfarë mbështetjeje për fëmijët pa kujdes prindëror, nëse ka, shihni që po ofrohet në kishën tuaj?
- A mund të ketë një përpjekje më të qëllimshme për të mobilizuar mbështetjen në këtë fushë?

PËR OJQ-TË DHE TË TJERËT QË MBËSHTESIN KISHAT



Të dhënat theksojnë nevojën thelbësore për **pajisjen e stafit dhe të vullnetarëve të kishës** me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për t'u shërbyer në mënyrë efektive fëmijëve dhe të rinjve të cënueshëm. Ndërsa shumë udhëheqës kishash e njohin potencialin e skuadrave të tyre, vetëm 34% besojnë se punonjësit e tyre janë plotësisht të pajisur, ndërsa 55% tregojnë një përgatitje të pjesshme. Për më tepër, trajnimi për vullnetarët dhe stafin është identifikuar si nevoja më urgjente në kontekstin e shërbesave, duke theksuar një dëshirë të përhapur për përmirësim në këtë drejtim.

- Çfarë mundësish shtesë për trajnim mund të zhvillohen për të mbështetur kishat në zona të pambuluara, si ato rurale, me qëllim që të kapërcehen mungesat në përgatitje?
- Çfarë çështjesh apo nevojash të thella mund të pasqyrohen në dëshirën për më shumë trajnim, përtej përvetësimit të aftësive?
- Cilat strategji mobilizimi apo arsimimi keni vënë re si më efektive në përvojën tuaj?

Kishat janë shumë të vetëdijshme për përhapjen e **dhunës në familje dhe sfidave të shëndetit mendor** brenda komuniteteve të tyre.

Megjithatë, pavarësisht kësaj vetëdijeje, shumë kisha nuk disponojnë burimet e nevojshme, trajnimin dhe programet e strukturuar për të adresuar këto çështje komplekse dhe të ndjeshme në mënyrë efektive. Përpjekjet për të trajtuar këto probleme shpesh kufizohen në mbështetje informale, si këshillimi ose lutja, në vend të ndërhyrjeve gjithëpërfshirëse ose të specializuara.




- Si mund të ofrojë organizata juaj trajnim, mjete ose partneritete për t'i ndihmuar kishat të trajtojnë më drejtpërdrejtë çështje të ndjeshme si dhuna në familje, abuzimi dhe shëndeti mendor?
- Si mund të bashkëpunoni me kishat për të ofruar mbështetje psikologjike për fëmijët dhe familjet në situata krize?
- A ka profesionistë të shëndetit mendor me të cilët mund të bashkëpunoni për të forcuar shërbesën e kishave?



Një nga hendejë e rëndësishëm që kemi identifikuar midis nevojave dhe mbështetjes ekzistuese, është rëndësia kritike e **mundësive më të mira për punësim dhe trajnim profesional**. Ndërkohë që ofrimi i trajnimit profesional mund të mos jetë roli kryesor i Kishës, mund të ketë mundësi për një fokus më të madh dhe bashkëpunim në këtë fushë. Kjo duket si një hapësirë ku partnerët lokalë mund të ndërhyjnë, duke shfrytëzuar marrëdhëniet me kishat dhe lidhjet me komunitetin për të nxitur mbështetje afatgjatë.

- Cili mund të jetë roli i organizatës suaj në pajisjen e kishave për të mbështetur iniciativat e trajnimit profesional ose mundësive për punësim?
- A ka programe trajnimi profesional me të cilët mund të lidhni kishat për të mbuluar hendejë në mbështetje për familjet e cënueshme?

Përtej çështjes së punësimit, ky raport thekson realitetin se **burimet e kishave** shpesh janë të kufizuara. Shumica e ndihmës dhe mbështetjes financiare që ofrojnë kishat është sporadike dhe trajtohet rast pas rasti. Megjithatë, kishat kanë një qasje dhe njohuri të veçantë për familjet e cënueshme përmes vizitave në shtëpi dhe marrëdhënieve të vazhdueshme. Kjo paraqet një **mundësi për të përqendruar burimet dhe përforcuar** kishat, në vend që të krijohen programe ose rrjete të reja nga e para.



- A ka mundësi që organizata juaj të lehtësojë partneritete midis kishave dhe organizatave të tjera që përqendrohen në fëmijët dhe familjet e cënueshme?
- Cili mund të jetë roli juaj në përpjekjet për të lidhur kishat me burimet lokale për të adresuar nevojat e komunitetit?



Abuzimi me substanca është një çështje kritike që ndikon në shumë familje të cënueshme, duke shkaktuar një sërë sfidash si pasiguria familjare, vështirësitë financiare dhe probleme të shëndetit mendor. Pavarësisht njohjes së rëndësisë së saj, pak kisha kanë zhvilluar programe të specializuara ose ndërhyrje për të adresuar në mënyrë konkrete abuzimin me substanca në komunitetet e tyre. Kjo ofron një mundësi për bashkëpunim me OJQ-të dhe autoritetet lokale për t'u ofruar kishave mjetet dhe trajnimet e nevojshme për të trajtuar abuzimin me substanca në mënyrë më efektive.

- Si mund t'i mbështesë organizata juaj kishat në zhvillimin e programeve të strukturuar për të adresuar abuzimin me substanca dhe pasojat e tij në familje?
- Cilat strategji mund të ndihmojnë në destigmatizimin e abuzimit me substanca brenda komuniteteve të kishave për të inkurajuar dialogun e hapur dhe ndërhyrjet efektive?



RRETH PROJEKTIT

Ruth Vergnon punon me fëmijë të cënueshëm përmes Alo ! Mik, një organizatë në Shqipëri që mbështet fëmijët që përballen me trauma ose pa kujdes prindëror. Në vitin 2023, ajo kontaktoi OneHope për të humluntuar se si kishat në Shqipëri po mbështesin familjet e cënueshme.

Si përgjigje, intervistua 90 udhëheqës kishash ungjillore rreth përpjekjeve të tyre për të ndihmuar familjet dhe fëmijët e cënueshëm. Intervistat u realizuan personalisht nga vullnetarët dhe stafi i Alo ! Mik, në shqip, dhe u përkthyen për analizë nga ekipi i kërkimit i OneHope. Falënderojmë veçanërisht Elona Deliu dhe Frederik Qokaj për kohën që ata i dedikuan grumbullimit të të dhënave, përfshirë udhëtimet, dëgjimin dhe regjistrimin e të dhënave hedhjes së tyre në sistem, përkthimit, rishikimit e korrektim/redaktimit në shqip.

Të dhënat u grumbulluan midis dhjetorit 2023 dhe korrikut 2024. Jo të gjithë udhëheqësit e kishave iu përgjigjën çdo pyetjeje, por madhësitë e mostrave ishin të mjaftueshme për të gjitha pyetjet në këtë raport. Kërkuesit transkriptuan dhe shqyrtuan intervistat, duke identifikuar idetë kryesore dhe temat e përsëritura. Këto tema u rafinuan përmes ciklesh të shumta rishikimi për të pasqyruar perspektivat e pastorëve. Analiza mori parasysh si përgjigjet direkte ashtu edhe kuptimet më të thella, duke theksuar dallimet në kontekst, për të kapur diversitetin e përvojave të kishave. Ky proces ofroi njohuri të vlefshme mbi sfidat dhe mundësitë që kishat shqiptare ofrojnë në mbështetje të familjeve të cënueshme.

RRETH ALO ! MIK-UT

Alo ! Mik është një Organizatë Jo Fitimprurëse, e frymëzuar nga besimi i krishterë, për t'u shërbyer fëmijëve dhe familjeve në nevojë. Alo ! Mik operon në Shqipëri që nga viti 2003, duke zbatuar projekte të ndryshme për të garantuar mirëqenien gjithëpërfshirëse të fëmijëve, veçanërisht për më të pambrojturit. Fusha e ekspertizës së Alo ! Mik varion nga ndërhyrjet e drejtpërdrejta të fëmijët dhe familjet e cënueshme, tek fuqizimi i aktorëve lokalë përmes trajnimit, rrjetëzimit dhe shkëmbimit të burimeve. alomik.org/sq


RRETH ONEHOPE

Në partneritet me kishat lokale, shërbesa dhe qeveri në mbarë botën, OneHope ka arritur më shumë se 2 miliardë fëmijë dhe të rinj me Fjalën e Perëndisë. Programet e Shkrimeve janë krijuar për t'u përshtatur me moshën dhe kulturën, bazuar në kërkimet që OneHope kryen në çdo vend. Që nga viti 1987, OneHope ka ndihmuar fëmijët të përjetojnë historinë e Perëndisë, duke shpërndarë mesazhin që ndryshon jetën dhe sjell shpresë për fëmijët dhe të rinjtë në çdo vend. onehope.net

RRETH WORLD WITHOUT ORPHANS EUROPE

WWO Europe është pjesë e një lëvizjeje globale që synon një botë ku çdo fëmijë të ketë përkujdesje në një familje të sigurt dhe plot dashuri dhe arrin potencialin e vet të dhuruar nga Perëndia. Organizata thërret dhe pajis udhëheqësit e krishterë në nivel kombëtar që të mundësojnë që të krishterët dhe kishat në vendin e tyre të adresojnë nevojat e jetimëve, fëmijëve në rrezik dhe familjeve të tyre. WWO Europe bashkëpunon me Alo ! Mik dhe Shqipëria pa Jetimë për të realizuar këtë vizion në Shqipëri. europe.withoutorphans.org





SHTOJCA A: PROJEKTET E PLANIFIKUARA PËR TË ARDHMEN

Edhe pse përqendrohemi kryesisht në situatën aktuale në Shqipëri, ne deshëm edhe të dëgjojmë se çfarë po planifikojnë kishat për të ardhmen.

A KA NDONJË PROJEKT QË PLANIFIKONI APO SHPRESONI TË OFRONI, POR NUK E KENI ZHVILLUAR ENDE? PSE JENI TË INTERESUAR TË ZHVILLONI KËTË PROJEKT?

59 udhëheqës kishash iu përgjigjën kësaj pyetjeje.

Kur shohin të ardhmen, udhëheqësit e kishave kanë një gamë të gjerë ëndrrash dhe planesh. Kemi përmbledhur këtu temat kryesore në të njëjtat kategori si më lart.

MBËSHTETJE EKONOMIKE

- **Nevojat themelore:** Paketa ushqimore, veshmbathje dhe mbështetje higjienike për familjet në nevojë, përfshirë vejushat dhe jetimët. Plane për programe ushqimore dhe një qendër kujdesi komunitar.
- **Ndihma për punësim:** Ngritja e shqetësimit për punësimin e individëve me aftësi të kufizuara; plane për trajnimin në punë dhe zhvillimin profesional në teknologji dhe zanate.
- **Aftësi financiare:** Projekte të orientuara për promovimin e pavarësisë financiare dhe aftësive financiare të familjet.

MBËSHTETJE PËR ARSIMIM

- **Programet pas-shkollore:** Iniciativa të ndryshme pas-shkollore që synojnë arsimimin e fëmijëve për të parandaluar braktisjen e shkollës dhe për të adresuar problemet e shkrim-leximit.
- **Arsimim i specializuar:** Plane për të ndihmuar fëmijët me autizëm dhe për të ofruar kurse në anglisht dhe lëndë të tjera.
- **Kurse prindërimi:** Kurse të përqendruara në edukimin e prindërve për praktikën e rritjes së fëmijëve dhe forcimin e marrëdhënieve familjare.

MBËSHTETJE PSIKO-EMOCIONALE

- **Mbështetje për familjet e divorcuara:** Projekte sociale të fokusuar në ndihmën për familjet e prekura nga divorci dhe forcimin e lidhjeve familjare.
- **Qendra rinore dhe familjare:** Iniciativa për krijimin e hapësirave të sigurta për angazhimin e rinisë përmes sporteve dhe arteve, me qëllim për të nxitur miqësitë dhe mirëqenien emocionale.

MBËSHTETJE PRINDËRORE

- **Kampe për marrëdhënie prind-fëmijë:** Kampet e përqendruara në përmirësimin e marrëdhënieve mes prindërve dhe fëmijëve, me theks tek prindërimi.
- **Përkujdesje e specializuar për kujdestarët:** Zhvillimi i shërbimeve për prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta, përfshirë shërbime kujdesi për fëmijët për t'u ofruar kujdestarëve mundësi pushimi.

MBËSHTETJE SHPIRTËRORE

- **Angazhimi i komunitetit:** Iniciativa të ndryshme nga kisha, të menduara për të integruar familjet në komunitetin e kishës përmes aktiviteteve shoqërore dhe shpirtërore.
- **Përpjekje për ungjillizim:** Programe që synojnë familjet, veçanërisht përmes fëmijëve, për të promovuar mësimet dhe vlerat e krishtera.

SHTOJCA B: GRAFIQE TË DETAJUARA

Kjo shtojcë përmban grafike me informacionet më të detajuara, të përmbledhura në raport.

RRETH KISHAVE

Disa nga kishat (43%) të përfaqësuara në këtë raport veprojnë në disa vendndodhje. Gjithsej studimi pasqyron informacion nga rreth 154 vendndodhje të veçanta të kishave.

KISHAT ME DISA VENDNDODHJE:

Kishat me disa degë/vendndodhje

57% – Jo

43% – Po

Nëse po, ku?

8%

37%

55%

3 – Kryeqytet

14 – Urbane

21 – Rurale

Sa vendndodhje të tjera?

63%

13%

13%

11%

24 – Një


5 – Dy

5 – Tre

4 – Katër ose më shumë


Kishat në Qendër dhe Juglindje kishin më shumë gjasa të kishin disa vendndodhje dhe të kishin më shumë se një degë tjetër.

NUMRI I DEGËVE SIPAS RAJONIT



Kishat urbane kishin më shumë gjasa të raportonin se kishin disa vendndodhje.

NUMRI I DEGËVE SIPAS VENDNDODHJES




PARANDALIMI DHE NDËRHJRJA SIPAS KISHAVE

A ka kisha juaj ndonjë politikë që lidhet posaçërisht me mbrojtjen apo mbështetjen e fëmijëve të cënueshëm?

Kishat në rajonin e Veriut kishin shumë më pak gjasa të thoshin se kishin politika për mbrojtjen e fëmijëve. Vetëm 36% thanë po për këtë pyetje, shumë më poshtë se mesatarja ose ndonjë nga rajonet e tjera.

POLITIKAT SIPAS RAJONIT




PËRKUJDESJA PËR JETIMËT

A keni dëgjuar për të Dielën e Jetimëve apo a keni organizuar diçka në atë ditë vitet e mëparshme?


Ndërgjegjësimi për të "Dielën e Jetimëve" ndryshonte shumë nga rajoni në rajon. Udhëheqësit e kishave në Veri dhe Jugperëndim dukeshin përgjithësisht të informuar për këtë ngjarje: më shumë se 70% e udhëheqësve në të dyja këto rajone thanë se ishin të njohur me të. Ndërkohë, më pak se 50% e udhëheqësve në rajonet Qendrore dhe Juglindore thanë se e dinin për të.

E DIELA E JETIMËVE SIPAS RAJONIT



Udhëheqësit e kishave në kryeqytet kishin më pak gjasa të ishin të njohur me këtë ngjarje. Vetëm 44% thanë se e dinin për të, krahasuar me 60% të udhëheqësve të tjerë urbanë dhe 71% të udhëheqësve ruralë.


E DIELA E JETIMËVE SIPAS VENDNDODHJES




A i mbështet kisha juaj ose ndonjë anëtar i kishës fëmijët pa kujdes prindëror (për shembull si familje kujdestare, familje birësuese, shtëpi fëmijësh/shtëpi-familje, të përfshirë në shtëpi fëmijësh)?

Kishat në veri kishin më pak gjasa të raportonin se anëtarët po mbështesin fëmijët pa kujdes prindëror (29% thanë po, krahasuar me 49% gjithsej). Shumë udhëheqës të kishave rurale thanë se nuk ishin të sigurt nëse kjo lloj mbështetjeje po zhvillohej në kishat e tyre (43% të pasigurt).

MBËSHTETJA E KISHAVE SIPAS RAJONIT



MBËSHTETJA E KISHAVE SIPAS VENDNDODHJES



Çfarë burimesh ose mjetesh përdorni për të ndarë Fjalën e Perëndisë dhe për t'i ndihmuar fëmijët të angazhohen?

Kishat rurale (100%) raportuan se përdorin ekskluzivisht materiale që kanë blerë ose që u janë dhënë. Kishat në Veri (21%) ishin më të prirura të krijojnë ose përkthenin materialet e tyre.

BURIMET SIPAS RAJONIT



BURIME SIPAS VENDNDODHJES




BURIME DHE PARTNERITETE


A besoni se punonjësit ose vullnetarët tuaj janë të pajisur mirë me njohuritë dhe aftësitë praktike të nevojshme për t'u shërbyer fëmijëve/të rinjve të cenueshëm?

Udhëheqësit e kishave rurale kishin më pak gjasa të mendonin se punonjësit e tyre ishin të pajisur mirë (vetëm 14% thanë po), ndërsa udhëheqësit e kishave në Veri ishin më të sigurt (57% thanë po).

PUNËTORËT E PAJISUR SIPAS RAJONIT




PUNËTORËT E PAJISUR SIPAS VENDNDODHJES




A punoni me ndonjë partner për të ndihmuar në adresimin e nevojave të familjeve tuaja në nevojë?

Kishat në juglindje (90%) kishin shumë më tepër gjasa se ato në rajone të tjera të thonin se punojnë me autoritetet lokale. Kishat rurale (57%) gjithashtu kishin më shumë gjasa të bashkëpunonin me autoritetet sesa kishat urbane.

PARTNERËT SIPAS RAJONIT



PARTNERËT SIPAS VENDNDODHJES





SHQIPËRIA

STUDIM MBI SHËRBESAT E KISHAVE
UNGJILLORE ME FËMIJËT DHE FAMILJET
E CENUESHME



OneHope
God's Word. Every Child.

